

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5678
E enjte, 17 janar 2019
çmimi 0.40 €

MASHT-i dhe drejtoritë komunale të arsimit kërkojnë të ndërpritet greva në arsim

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI | FAQE 4-5

Kuvendi do ta përkrahë peticionin për bashkimin e Mitrovicës



Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, ka shprehur optimizëm se iniciativa për bashkimin e Mitrovicës do të ketë sukses qind për qind. Ai ka bërë me dije se Kuvendi do ta përkrahë peticionin për bashkimin e

Mitrovicës të cilin e ka dorëzuar të mërkurën te kryeparlamentari Kadri Veseli. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka treguar se në këtë rrugëtim nuk është i vetëm, mirëpo e ka mbështetjen e pozitës dhe

të opozitës. Sipas tij, Mitrovica do të jetë një komunë e bashkuar, me vetëm një kryetar, i cili selinë do ta ketë në pjesën e veriut dhe do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pavarësisht prej kombësisë së tyre

KA FILLUAR NË HAGË INTERVISTIMI I ISH-KOMANDANTIT TË UÇK-SË PËR ZONËN E DRENICËS, SAMI LUSHTAKU

Thaçi: Çlirimtarët padrejtësisht po intervistohen në Hagë

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbrojtur ish-komandantin e UÇK-së, Sami Lushtaku, në ditën që ky i fundit është intervistuar nga Gjykata Speciale në Hagë. Thaçi ka thënë se Lushtaku dhe komandantët e tjerë të UÇK-së po intervistohen padrejtësisht në Hagë, kurse kriminelët serbë po shëtisin lirshëm. Ish-komandanti i UÇK-së për Zonën e Drenicës, Sami Lushtaku, të mërkurën disa orë resht është intervistuar në Hagë | FAQE 3



Hoxhaj: Këtë vit nuk ka zgjedhje të reja dhe as rrëzim të Qeverisë

FAQE 7

AKTUALE

PERSONALIZIMI I INSTITUCIONEVE

F. 11

Shkruan:
Xhavit HALITI



A PO PËRDORET TAKSA 100 PËR QIND SI ARSYETIM PËR RRËZIMIN E QEVERISË SË KOSOVËS?

F. 11



VESELI PRANON PETICIONIN PËR BASHKIMIN E MITROVICËS

F. 5

EKONOMI

NËNKRYETARJA E VETËVENDOSJES: LIGJI PËR PAGAT ËSHTË MASHTRIM

F. 8

FILLON ZBATIMI I LIGJIT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

F. 9

KULTURË

IKU EDHE KY VIT

F. 12

Poezi nga
Sabile KEÇMEZI-
BASHA



SPORT

MOSPËRFUNDIMI I PUNIMEVE NË PALESTËR, BRENGA E VETME PARA 'FINAL 8'

F. 20

MAVRAJ: TE HAMBURGU NUK MË TRAJTUAN SIÇ DUHET

F. 21

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, 10000
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Personalizimi i institucioneve



Shkruan: Xhavit HALITI

Zhvillimet e fundit politike në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë kanë nxjerrë në pah një dukuri tepër të ngjashme: Në të dy shtetet ka një "përplasje" me karakter thellësisht politik në mes të presidentëve dhe kryeministrave aktualë. Janë katër figura politike konkrete, që kanë mes vete njohje miqësore të

hershme, që janë pozicionuar në pozicione të ndryshme dhe e kanë filluar "një luftë verbale". Aktorët e kësaj shfaqjeje, me efekte negative e shqetësuese për opinionin mbarëshqiptar në Ballkan e më gjerë, kanë emra konkretë dhe qëndrojnë në krye të institucioneve më të larta shtetërore në republikat tona parlamentare.

Në Kosovë dhe në Shqipëri është bërë evidente, gati njëkohësisht, kundërshtia edhe mediatike mes Presidentit dhe Kryeministrit. Arsyet e kësaj përballjeje mes tyre, që ndryshojnë në thelb nga njëra-tjetra, janë të njohura, siç mendoj se është i njohur edhe mospëlqimi i opinionit për gjuhën dhe epitetet e përdorura

nga palët në këtë "përplasje". Këto dukuri të ngjashme të "moskuptimeve dhe e mospajttimeve" mes figurave më të larta shtetërore në të dy vendet, dëshmojnë se: jo vetëm në Kosovë, (si shtet me moshë fare të re), por dhe në Shqipëri (shtet mbi njëqindvjeçar), ndërtimi i institucioneve, ndërveprimi i domosdoshëm në respekt të ligjit dhe në pushtet të ligjit, ende mungon. Edhe kur këto ekzistojnë faktikisht, (me Kushtetutë) shpesh dominohe mi nga dukuri dhe veprime me rëndesë të ndjeshme autokratike.

Dihet që pluralizmi politik është fillësë dhe bazamenti i demokracisë. Krijimi, funksionimi dhe konkurrimi mes pro-

grameve partiake dhe fushatave elektorale, me ose pa aleanca, qojnë në marrjen e pushtetit përmes votës. Marrja e pushtetit është rezultat vetëm e vetëm i votës së elektoratit; pushteti shpërndahet dhe realizohet nga individë konkretë. Kjo dihet, kurdoherë politika vepruese është kompetencë dhe detyrim për t'u realizuar nga parti e nga individë. Por politika, sidomos materializimi i saj, është vështirë të realizohet sipas programeve, kur në realitet shpesh zbatohet vetautorësia nga këta individë që kanë marrë votën popullore. Fenomeni i "autokracisë" që në shqip përkthehet "vetëpushtet" është një fenomen i njohur njerëzor. Uni, është i gjithëpushtetshëm për njeriun, që kur

është ende fëmijë, por fuqizohet shumëfish në garën për pushtet. Uni, që bëhet inekzistent dhe nuk heziton të vetëflijojë për lirinë e vendit, për nderin apo dashurinë, ringrihet (për të mos thënë gërthet) kur i kërcënohet apo lëkundet pozita pushtetore. Personalizimi i pushtetit politik, i institucioneve të larta shtetërore apo dhe atij partiak, në realitetin aktual në Kosovë e në Shqipëri, në të dy anët e kufirit, jo vetëm po e "vret demokracinë", por po dëmton rëndë ekzistencën e shtetit, funksionimin normal të tij dhe imazhin ndërkombëtar të dy shteteve tona sovraane në Evropë.

(Autori është nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës)

Suhareka dhe Podujeva, nivelin më të ulët të ekstremizmit

PRISHTINË, 16 JANAR - Në kohën kur Kosova po përballej me shkuarjen e një numri të qytetarëve të saj në Siri, dy komuna, Suhareka dhe Podujeva, nuk u prekën nga ky fenomen. Sipas një hulumtimi të Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave - KIPRED, Podujeva ka vetëm një person të përfshirë në grupet terroriste në luftën e Sirisë dhe Irakut, kurse Suhareka nuk ka asnjë të tillë. "Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, nga Komuna e Podujevës grupeve terroriste në Siri dhe Irak u është bashkangjitur vetëm një individ. Aktualisht, Policia nuk ka kurrfarë informate për personin në fjalë, përveç faktit se ai nuk gjendet në territorin e Komunës së Podujevës. Sipas burimeve të njëjta, edhe dy persona të tjerë kanë tentuar t'u bashkohen grupeve që luftojnë në Siri, mirëpo ata janë parandaluar nga Policia e Kosovës", thuhet në hulumtimin e publikuar nga KIPRED.

Në hulumtim më tej thuhet se aktualisht në Komunën e Podujevës nuk vepron asnjë organizatë joqeveritare që propagandon forma më radikale të islamit. Sipas këtij hulumtimi, në të kaluarën ka pasur tentativa, kryesisht nga organizata që kanë shpërndarë ndihma apo kanë ndihmuar financiarisht, mirëpo përfaqësuesit e këtyre organizatave janë larguar me kërkesë të Këshillit të Bashkësisë Islame në këtë komunë, me arsyetimin se kanë vepruar jashtë rregullave të BIK-ut.

Ndërkohë, komuna e Suharekës, sipas hulumtimit "Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm: mësimet nga shembujt pozitivë të komunës së Podujevës dhe Suharekës", është një nga komunat me nivelin më të ulët të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në mbarë Kosovën. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, asnjë person nga Suhareka nuk u është bashkuar grupeve terroriste në Siri dhe Irak. Policia, po ashtu, nuk ka të dhëna nëse ndonjë person nga ky qytet ka tentuar t'u bashkohet grupeve terroriste në Siri dhe Irak.

Në hulumtim thuhet se faktori kryesor që ka kontribuar për parandalimin e shfaqjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këto dy komuna është veprimi i drejtë dhe i duhur nga ana e Këshillave të Bashkësisë Islame. "Në të dy rastet, KBI-të në fjalë që nga fillimi i kanë rezistuar instalimit të organizatave dhe individëve që kanë insistuar në predikimin e formave radikale të islamit. Vazhdimisht është biseduar me popullatën jo vetëm në xhami gjatë namazit, por edhe gjatë tubimeve, nëpër shkolla dhe në medime. Janë demaskuar ideologjitë e këtitilla radikale si të huaja dhe të dëmshme për shqiptarët në Kosovë", thuhet në hulumtimin e publikuar nga KIPRED.

Në hulumtim më tej thuhet se organizatat dhe shoqatat me prirje radikale dhe ekstremiste e kanë pasur të pamundur, sido-

mos gjatë fazës së pasluftës, që të gjejnë terren për t'i shpërndarë ideologjitë e tyre në këto dy komuna.

Një nga faktorët që ka ndikuar në parandalimin e shtrirjes së ide-

ologjive radikale dhe ekstremiste është edhe procesi i kontrollit të përzgjedhjes së imamëve.

Nga fillimi i luftës në Siri, mbi 400 kosovarë besohet se kanë shkuar në zonat e luftës në Siri dhe Irak.

Më shumë se 130 persona janë dënuar në Kosovë për pjesëmarrje në luftërat në Siri dhe Irak, ndërkaq në këto zona janë vrarë më shumë se 70 kosovarë dhe rreth 200 ende mbesin atje.



Në Hagë ka filluar intervistimi i ish-komandantit të UÇK-së për Zonën e Drenicës, Sami Lushtaku

Thaçi: Çlirimtarët padrejtësisht po intervistohen në Hagë



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbrojtur ish-komandantin e UÇK-së, Sami Lushtaku, në ditën që ky i fundit është intervistuar nga Gjykata Speciale në Hagë. Thaçi ka thënë se Lushtaku dhe komandantët e tjerë të UÇK-së po intervistohen padrejtësisht në Hagë, kurse kriminelët serbë po shëtisin lirshëm. Ish-komandanti i UÇK-së për Zonën e Drenicës, Sami Lushtaku, për disa orë është intervistuar të mërkurën në Hagë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 JANAR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për Zonën e Drenicës, Sami Lushtaku, për disa orë rresht është intervistuar të mërkurën nga Prokuroria Speciale në Hagë. Pas intervistimit, as Lushtaku dhe as avokati i tij mbrojtës, Geoffrey Nice, nuk kanë folur për medie në lidhje me atë se për çfarë është intervistuar. Në lidhje me këtë intervistim ka reaguar edhe presidenti i

vendit, Hashim Thaçi. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se në Hagë padrejtësisht po intervistohet Sami Lushtaku, kurse kriminelët serbë që kanë bërë masakra në rajonin e Drenicës vazhdojnë të shëtisin lirshëm në Serbi dhe botë. "Sot në Hagë po intervistohet bashkëlufëtari ynë Sami Lushtaku, që vjen nga rajoni i Drenicës, ku forcat serbe masakruan me qindra civilë të pafajshëm dhe drejtësia ndërkombëtare as që është marrë me krimet e tyre", ka

shkruar presidenti Thaçi derisa ka numëruar masakrat në rajonin e Drenicës të kryera nga forcat serbe. "Në fshatrat Likoshan dhe Çirez të Drenicës, më 28 shkurt 1998, forcat serbe vranë dhe masakruan 24 civilë të pafajshëm. Në Prekaz, më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, forcat serbe vranë dhe masakruan 56 anëtarë të familjes Jashari. Më 26 shtator 1998, në Abri të Epërme të Drenicës, forcat serbe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu. Më 28 mars 1999 forcat serbe në fshatin Izbicë vranë dhe

masakruan mizorisht 147 shqiptarë të pafajshëm. Më 5 prill 1999, në fshatin Rezallë, ushtria dhe policia serbe vranë 98 civilë, banorë të Rezallës dhe fshatrave përreth, nga të cilët 44 ishin të zhdukur. Po në muajin prill të vitit 1999, forcat serbe vranë dhe masakruan edhe 54 civilë në Poklek të Ri dhe 24 civilë të tjerë në Çikatovë të Vjetër. Forcat policore dhe ushtarake serbe vranë dhe masakruan edhe qindra civilë të tjerë të pafajshëm anekënd Drenicës dhe Kosovës, por drejtësia ndërkombëtare as që ka nisur të merret me këto krime", ka shkruar Thaçi. Sipas tij, kjo është një padrejtësi që po u bëhet ish-pjesëtarëve të UÇK-së. "Sot, padrejtësisht, po intervistohet një çlirimtar në Hagë, kurse kriminelët serbë vazhdojnë të shëtisin lirshëm në Serbi dhe botë. Ndaj çlirimtarëve tanë, në

emër të drejtësisë ndërkombëtare, po bëhet padrejtësia më e madhe", ka shkruar Thaçi. Një ditë më parë intervistimin nga Specialja e ka përfunduar edhe ish-komandanti i UÇK-së për Zonën Operative të Llapit, Rustem Mustafa-Remi. Pas intervistimit, prej gati dhjetë orësh, Mustafa ka thënë para gazetarëve se UÇK-ja e ka mbrojtur atë dhe jo ai UÇK-në. "Pyetjet kanë qenë shumë serioze dhe ne kemi qenë shumë seriozë në përgjigje. UÇK-ja më ka mbrojtur mua dhe unë nuk kam pasur nevojë ta mbroj UÇK-në", ka thënë Mustafa jashtë ndërtesës së Prokurorisë. Ai nuk ka treguar se në çfarë cilësie është intervistuar. "Sot përfundoi intervista me mua pranë Dhomës së Specializuar në Hagë. Unë isha i ftuar si dëshmitar i dyshuar", është shprehur Rustem Mustafa.

MASHT-i dhe drejtoritë komunale të arsimit kërkojnë të ndërpritet greva në arsim

Prishtinë, 16 janar (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka mbajtur të mërkurën një takim me drejtorët e drejtorive komunale të arsimit, me të cilët ka diskutuar për gjendjen e krijuar pas fillimit të grevës në arsim dhe për mundësitë për të dalë nga kjo situatë. Ministri Bytyqi i ka informuar drejtorët e drejtorive për angazhimin që ka bërë MASHT-i në mënyrë që të arrihet sa më parë një marrëveshje për të dalë nga kjo gjendje, e cila më së shumti po i dëmton nxënësit. Gjatë këtij takimi, secili nga drejtorët e drejtorive u deklaruan se janë kategorikisht kundër grevës dhe shprehën besimin e tyre që aktorët vendimmarrës shumë



shpejt të gjejnë një zgjidhje e cila do të rezultojë me ndërprerjen e grevës.

Në këtë takim u morën dy vendime: I bëhet thirrje SBASHK-ut për ndërprerjen e grevës në të gjithë sistemin arsimor, në veçanti nëpër çerdhe që nga dita

e nesërme, dhe u formua grupi punues që do të udhëhiqet nga ministri Bytyqi, pjesë e të cilit do të jenë tre drejtorë të DKA-ve dhe një përfaqësues nga Këshilli i Prindërve, grup i cili do të zhvillojë takime me përfaqësues të SBASHK-ut dhe aktorët e tjerë

vendimmarrës në funksion të arritjes së një zgjidhje.

Edhe dita e tretë e grevës së përgjithshme të SBASHK-ut ka dëshmuar unitetin dhe këmbëngulësinë për realizimin e kërkesës për ngritje të koeficienteve për 30 për qind për tërë sektorin e arsimit duke filluar nga çerdhet, arsimit parauniversitar dhe universitetet. Raportet që kanë arritur në Këshillin Qendror nga këshillat greviste nga komunat e Kosovës dhe universitetet tregojnë se çerdhet dhe të gjitha institucionet e tjera të arsimit vazhdojnë të qëndrojnë të paluhatur në grevën e përgjithshme.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, me anëtarë të Këshillit Qendror Grevist dhe me përfaqë-

suesen e çerdheve në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut, Flora Gashi, kanë vizituar Komunën e Lipjanit për t'u takuar me grevistët në Shkollën Filllore e të Mesme të Ulët "Vëllezërit Frashëri" dhe në çerdhen e kësaj qyteze.

Kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar edhe punëtorët e arsimit në Lipjan për unitetin e argimtar dhe ka përsëritur se do të jetë zë i tyre në angazhimin për realizimin e kërkesave legjitime. Ai ka thënë se duke respektuar zërin e punëtorëve të arsimit dhe vendimin e Këshillit Drejtues greva do të vazhdojë deri në plotësimin e kërkesës legjitime të SBASHK-ut lidhur me përmirësimin e koeficienteve.

Flet për "Epokën e re", Agim Bahtiri

Kuvendi do ta përkrahë peticionin



Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, ka shprehur optimizëm se iniciativa për bashkimin e Mitrovicës do të ketë sukses qind për qind. Ai ka bërë me dije se Kuvendi do ta përkrahë peticionin për bashkimin e Mitrovicës të cilin e ka dorëzuar të mërkurën te kryeparlamentari Kadri Veseli. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka treguar se në këtë rrugëtim nuk është i vetëm, mirëpo e ka mbështetjen e pozitës dhe të opozitës. Sipas tij, Mitrovica do të jetë një komunë e bashkuar, me vetëm një kryetar, i cili selinë do ta ketë në pjesën e veriut dhe do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pavarësisht prej kombësisë së tyre

biseduar me nënkryetarin e parë të LDK-së, Agim Veliu, edhe me kryetarin e Vetëvendosjes, Albin Kurtin", ka deklaruar Bahtiri. Sipas tij, Mitrovica do të jetë një komunë e bashkuar, me vetëm një kryetar, i cili selinë do ta ketë në pjesën e veriut dhe do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pavarësisht prej kombësisë së tyre. Bahtiri u ka bërë thirrje institucioneve që të kontribuojnë në procesin e bashkimit të Mitrovicës sepse, sipas tij, kjo është në të mirën e shtetit dhe popullit. "Ky është vullnet i qytetarëve, vullnet i atyre që e duan Mitrovicën me zemër dhe kryetari që është zgjedhur nga populli do ta dëgjojë popullin. Unë jam shërbëtor i popullit dhe jo i partisë politike. Prandaj u bëj thirrje të gjitha institucioneve që të kontribuojnë në këtë proces duke e mundësuar atë që është në të mirë të popullit, bashkimin e Mitrovicës", ka theksuar kryetari Bahtiri.

"Epoka e re": Kryetar, të mërkurën i keni dorëzuar kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit, peticionin me 16 594 nënshkrime përmes të cilit synoni bashkimin e Mitrovicës. Prisni mbështetjen e Kuvendit për jetësimin e këtij peticioni?

Bahtiri: Natyrisht se pres mbështetjen e Kuvendit të Kosovës për peticionin për bashkimin e Mitrovicës. E di saktë se peticioni do të kalojë dhe kjo do të jetë çështje madhore për të gjithë qytetarët e Kosovës, në veçanti për ata të Mitrovicës. Bashkimi i Mitrovicës është kërkesë legjitime që po bëhet përmes Kuvendit në pamundësi që kjo procedurë të shkojë përmes ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal i cili është nga komuniteti serb. Kjo na ka detyruar që ta bëjmë një peticion dhe për pesë ditë janë mbledhur 16 594 nënshkrime dhe nënshkrues të tij janë edhe

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, të mërkurën e ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës peticionin me 16 594 nënshkrime të qytetarëve për bashkimin e Mitrovicës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka shprehur bindjen se Kuvendi do ta përkrahë këtë peticion. "Ky peticion do të ketë sukses sepse është vull-

net i qytetarëve dhe vullneti i qytetarëve është fuqia më e madhe që jep rezultat. Këtë vullnet e kanë edhe qytetarët serbë në Kosovë të cilët janë lodhur nga strukturat paralele të Serbisë. Jemi munduar me çdo kusht që të bashkëpunojmë me veriun, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Të gjithë duan që Mitrovica ta ketë statusin e qytetit të bashkuar. Shpresoj shumë dhe jam i bindur se Kuvendi i Kosovës do ta përkrahë peticionin për

bashkimin e Mitrovicës", është shprehur Bahtiri. Ai ka treguar se në këtë rrugëtim nuk është i vetëm, mirëpo e ka mbështetjen e pozitës dhe të opozitës. "Po, e kemi edhe mbështetjen e tyre. Unë jam në koalicion me Vetëvendosjen në Mitrovicë dhe aktivistët e Vetëvendosjes, bashkë me të tjerët, kanë mbledhur nënshkrimet e peticionit. Jam shumë i bindur se ata do ta mbështesin peticionin për bashkimin e Mitrovicës. Për këtë arsye kam

nin për bashkimin e Mitrovicës



disa qytetarë të komunitetit serb të cilët nuk janë lodhur nga strukturat paralele që dirigjohen nga Serbia.

"Epoka e re": *Ka rrezik që edhe ky peticion ta ketë fatin sikurse të tjerët, pra të mbete në sirtarët e Kuvendit?*

Bahtiri: Duhet ta dini se kryetari Agim Bahtiri nuk merr asnjë nismë pa pasur përkrahje. Do t'ia dal me sukses kësaj nisme sepse jam konsultuar me shumë njerëz brenda dhe jashtë vendit. Kam biseduar me përfaqësuesit e subjekteve politike dhe me deputetë të shumtë të cilët më kanë përkrahur plotësisht. Shpresoj dhe jam i bindur se çdo shqiptar i cili e ka një pikë gjak shqiptari do ta përkrahë iniciativën për bashkimin e Mitrovicës. Mitrovicës i është bërë një e padrejtë dhe rreth 15 000 banorë të pjesës së veriut janë refugjatë në qytetin e vet dhe nuk mund të kthehen në pronat e tyre. Nëse shteti i Kosovës ia mundëson secilit qytetar të ndihet i lirë, kjo që po ndodh në veri nuk do të ndodhë më tutje. Mitrovica do të jetë një komunë e bashkuar, me vetëm një kryetar i cili selinë do ta ketë në pjesën e veriut dhe do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pavarësisht prej kombësisë që i takojnë.

"Epoka e re": *Do ta zhvendosni zyrën në veri?*

Bahtiri: Po, kryetari i Mitrovicës të bashkuar do të

jetë në pjesën e veriut.

"Epoka e re": *Keni marrë mbështetje edhe nga partitë opozitare?*

Bahtiri: Po, e kemi edhe mbështetjen e tyre. Unë jam në koalicion me Vetëvendosjen në Mitrovicë dhe aktivistët e Vetëvendosjes, bashkë me të tjerët, kanë mbledhur nënshkrimet e peticionit.

"Epoka e re": *Peticionit i duhet mbështetja e Vetëvendosjes në qendër, pra votat e deputetëve në Kuvend.*

Bahtiri: Jam shumë i bindur se ata do ta mbështesin peticionin për bashkimin e Mitrovicës. Për këtë arsye kam biseduar me nënkryetarin e parë të LDK-së, Agim Veliu, por edhe me kryetarin e Vetëvendosjes, Albin Kurtin.

"Epoka e re": *Megjithatë, iniciativa juaj nuk ka marrë mbështetjen e kryeministrit Haradinaj.*

Bahtiri: Ky është mendimi juaj. Unë nuk e di që Haradinaj nuk e mbështet këtë iniciativën.

"Epoka e re": *Nuk e di se çfarë ju ka thënë personalisht, por në deklarata publike nuk e ka mbështetur.*

Bahtiri: Mbase e keni dëgjuar në një rrethanë tjetër, mirëpo unë kam biseduar me të dhe me kryetarët e komunave të AAK-së të cilët më përkrahin qind për qind. Por, është Kuvendi i Republikës së

Kosovës ai që do të marrë vendim si organi më i lartë i shtetit dhe nuk kam dilemë se nisma për bashkimin e Mitrovicës do të përfundojë me sukses.

"Epoka e re": *Çfarë do të bëni në rast se do të dështojë?*

Bahtiri: Sa herë kam marrë vendime me qytetarë kam pasur sukses. Besoj se edhe tani do të kem sukses.

"Epoka e re": *Kryetar, si është e mundur që Mitrovica të bashkohet me anë të një peticioni kur një gjë e tillë nuk ka mundur të ndodhë gati që 20 vjet as nga vendorët e as nga bashkësia ndërkombëtare, madje as pas procesit të dialogut?*

Bahtiri: Ky peticion do të ketë sukses sepse është vullnet i qytetarëve dhe vullneti i qytetarëve është fuqia më e madhe që jep rezultat. Këtë vullnet e kanë edhe qytetarët serbë në Kosovë të cilët janë lodhur nga strukturat paralele të Serbisë. Jemi munduar me çdo kusht të bashkëpunojë me veriun, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe qytetarët janë të zhgënjyer me këtë, prandaj tani janë të gjithë që Mitrovica ta ketë statusin e qytetit të bashkuar. Shpresoj shumë dhe jam i bindur se Kuvendi i Kosovës do ta përkrahë peticionin për bashkimin e Mitrovicës.

"Epoka e re": *Z. Bahtiri, Kosova dhe Serbia po synojnë arritjen e një marrëveshje përfundimtare. Bashkimi i*

Mitrovicës do të jetë në kuadër të kësaj marrëveshje?

Bahtiri: Nisma jonë ka për qëllim që të mos cenohet integriteti territorial i Kosovës. Dihet qëndrimi im sa i përket çështjes së kufijve. Peticioni ka të bëjë me Mitrovicën e cila ka qenë një komunë dhe do të jetë e tillë. Jam i bindur se iniciativa për bashkimin e Mitrovicës do të ketë sukses qind për qind.

"Epoka e re": *Si do që të jetë, në opinion ka pasur zëra se këtë iniciativë e keni bërë për arsye politike dhe për vota. Ka diçka të vërtetë në këtë?*

Bahtiri: Kjo është për të qeshur. Agim Bahtiri asnjëherë nuk është politik. Po të dua të bëj politikë bëj gjithë ditën, por kjo nuk ndodh. Ky është vullneti i qytetarëve, vullneti i atyre që e duan Mitrovicën me zemër dhe kryetari që është zgjedhur nga populli do ta dëgjojë popullin. Unë jam shërbëtor i popullit dhe jo i partisë politike. Prandaj u bëj thirrje të gjitha institucioneve që të kontribuojnë në këtë proces duke e mundësuar atë që është në të mirë të popullit, bashkimin e Mitrovicës.

"Epoka e re": *Po që se bëhet kështu si ia keni mësyre, do të hyni në histori që e keni bashkuar Mitrovicën pas 20 vjetësh të ndarjes.*

Bahtiri: Unë nuk do të hyj në histori, por do të hyjë populli i Mitrovicës që ka vuajtur shumë nga kjo ndarje dhe nga kjo padrejtësi. Ky do të jetë viti i bashkimit të Mitrovicës.

Veseli pranon peticionin për bashkimin e Mitrovicës

PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore, Agim Bahtiri, i ka dorëzuar të mërkurën peticionin me 16 594 nënshkrime të qytetarëve për bashkimin e qytetit të Mitrovicës, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselit. Me këtë rast ai ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që t'i ndërmarrin procedurat e nevojshme ligjore për realizimin e vullnetit të qytetarëve për bashkimin e Mitrovicës.

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Mitrovica do të mbetet për jetë e Kosovës dhe se peticioni do të trajtohet në mënyrë shumë serioze. "Është një peticion që do të trajtohet në Kuvendin e Kosovës në bazë të

procedurave që kemi. Kemi shumë njerëz të cilët kërkojnë të mbrohen të drejtat e tyre nga ne. Ne do të punojmë bashkërisht që të mos ketë acarim dhe eskalim të situatës. Mitrovica është qyteti i mitrovicasve dhe peticioni do të trajtohet në mënyrë shumë serioze. Ai së pari do të shkoj në komisionin përkatës parlamentar dhe do ta kemi momentin e vendimarrjes. Mitrovica është e mitrovicasve dhe Mitrovica do të jetë përjetë e Kosovës", ka thënë Veseli.

Peticioni për bashkimin e qytetit të Mitrovicës ka filluar në fund të vitit të kaluar dhe brenda shtatë ditësh janë mbledhur gjithsej 16 594 nënshkrime nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.



Bahri Hyseni merr zyrtarisht detyrën e kryesuesit të KPK-së

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 JANAR - Në Këshillin Prokurorial të Kosovës është mbajtur ceremonia e pranimit të detyrës së kryesuesit të KPK-së nga Blerim Isufaj te kryesuesi i sapozgjedhur, Bahri Hyseni, në të cilën kanë marrë pjesë zëvendëskryesuesi i KPK-së, Arben Ismajli, drejtori i Sekretariatit të KPK-së, Lavdim Krasniqi dhe drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Valon Jupa.

Gjatë kësaj ceremonie kryesuesi i deritashëm, Blerim Isufaj, i ka uruar mirëseardhje kryesuesit të ri, Bahri Hyseni, me ç'rast ka theksuar se ndihet i nderuar që ka pasur fatin dhe mundësinë ta udhëheqë këtë institucion të rëndësishëm përgjatë këtyre tre vjetëve, duke arritur suksese në një kohë sfidash të mëdha për vendin, njëkohësisht ka shtuar se është i lumtur që detyrën ia lë një profesionisti të madh të sistemit të drejtësisë, i cili ka dhënë kontribut të çmuar për sistemin prokurorial të Kosovës. Ndërsa kryesuesi i ri i KPK-së, Bahri Hyseni, ka falënderuar kryesuesin e deritashëm për



kontributin e tij për zhvillimin e sistemit prokurorial gjatë mandatit trevjeçar, duke thënë se do ta dinamizojë, avancojë dhe plotësojë edhe më tej misionin e Këshillit dhe do të jetë në shërbim të plotë të fuqizimit dhe zbatimit të ligjit në Kosovë. "Efikasiteti në veprimtarinë e përgjithshme prokuroriale, përmbushja e qëllimeve strategjike, arritja me kohë e rezultateve të nevojshme dhe krijimi i planeve dhe pro-

grameve adekuate, por edhe fuqizimi i transparencës dhe përgjegjësisë së përgjithshme ndaj detyrave që kemi përpara, do të jenë përpjekjet e mia të vazhdueshme dhe këmbëngulëse në krye të Këshillit", ka thënë kryesuesi i ri i KPK-së, Bahri Hyseni, i cili u zgjodh kryesues në takimin e 160 të KPK-së me votat unanime të të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe do të jetë në krye të tij për një mandat dyvjeçar.

Ismaili ripërsërit: Do të rriten pagat për punonjësit e shëndetësisë



PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka ripërsëritur zotimin e vet se do të rriten pagat për punonjësit e shëndetësisë. Ismaili ka thënë se mjekët do të kenë paga të dinjitetshme. "Edhe një herë, për të gjithë ata të cilët dyshojnë, nuk dëshirojnë të kuptojnë, apo qëllimisht po e përdorin këtë situ-

atë për përfitime politike: Pagat për profesionistët shëndetësorë po i rrisim. Mjekët tanë do të kenë trajtim dhe paga të dinjitetshme. Projektligji që garanton këtë rritje do të kalojë së bashku me buxhetin brenda pak ditësh. Unë u bëj thirrje të gjithë deputetëve, të të gjitha partive, në veçanti atyre opozitare, që në

vend se të flasin kundër rritjes së pagave për mjekët, të organizohen dhe ta përkrahin këtë projektligj në Kuvendin e Kosovës. I kuptoj lojërat politike, mirëpo mjaft është bërë politikë me mjekët. Tani është koha që të punojmë për ta!", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".



Katër operime specifike në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare në QKUK

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Për herë të parë në Kosovë, në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), me sukses të plotë janë kryer katër operime (Bypass axilo-bifemoralis). Ky bypass (urëzim) i qarkullimit të gjakut ka të bëjë me marrjen e gjakut nga arteria axilaris (arteria e nënsqetullës) dhe dërgimi i tij në drejtim vertikal deri tek arteria femoralis (arteria e këmbës së djathtë), e pastaj urëzimi tjetër në drejtim transversal, nga qarkullimi i gjakut në këmbën e djathtë në arterien e këmbës së majtë, me ndihmën e një gypi vaskular artificial (proteze vaskulare PTFE të diametrit 8 mm dhe gjatësi 80 cm).

Sipas njoftimit të QKUK-së, rasti i parë është pacienti I. S., 67 vjeç, i cili e kishte të mbyllur aortën abdominale (arterien kryesore të trupit të njeriut), në nivel të ndarjes së arterieve renale (arteriet e veshkave) nga aorta abdominale. Përveç kësaj, pacienti i dytë, M. M., 74 vjeç, kishte të mbyllura edhe dy arteriet femorale sipërfaqësore, që ushqejnë këmbët me gjak.

Për më tepër kishte edhe stenoze ostiale (ngushtim në hyrje) të dy arterieve femorale profunde. "Pacienti M. R., 80 vjeç, kishte të mbyllur aortën abdominale dhe ngushtime të shprehura në arteriet e veshkave. Kishte një zgjerim të aortës së kraharorit, mbyllje të dy arterieve femorale sipërfaqësore që ushqejnë këmbët me gjak. Ndërkaq, pacienti i katërt, pacienti S. R., 81 vjeç, e kishte të mbyllur aortën abdominale nën veshka, kishte ngushtime në arteriet e veshkave. Kishte edhe një zgjerim mesatar të aortës së kraharorit, mbyllje të arteries femorale sipërfaqësore të majtë. Kishte ngushtim të shprehur në hyrjen e të dy arterieve femorale profunde dhe një aterosklerozë të gjeneralizuar të të gjitha arterieve", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.

Te të gjithë pacientët, pas operacioneve, janë kryer ekzaminimet kontrolluese, ku është konstatuar se intervenimi kirurgjik ishte kryer me sukses të plotë dhe pacientët mesatarisht, pas pesë ditë hospitalizimi, janë lëshuar në shtëpi, në gjendje të përgjithshme dhe lokale të mirë.

Zyrtarët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) e kanë përgënjeshtuar nënkryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Hazirin, se PDK-ja i ka ofruar LDK-së mundësinë për ta rrëzuar Qeverinë e udhëhequr nga Haradinaj

Hoxhaj: Këtë vit nuk ka zgjedhje të reja dhe as rrëzim të Qeverisë

Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj dhe nënkryetari i këtij subjekti politik, Memli Krasniqi, kanë mohuar pretendimet e nënkryetarit të LDK-së, Lutfi Haziri, se PDK-ja i ka ofruar mundësinë LDK-së për ta rrëzuar Qeverinë e udhëhequr nga Haradinaj. Hoxhaj ka thënë se këtë vit nuk ka zgjedhje të parakohshme, as rrëzim të Qeverisë dhe as ndryshim të partnerëve në koalicionin qeverisës



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 JANAR - Zyrtarët më të lartë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) e kanë përgënjeshtuar të mërkurën nënkryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Hazirin, i cili ka thënë se PDK-ja i ka ofruar bashkëpunim kësaj partie për rrëzimin e Qeverisë së udhëhequr nga Haradinaj.

Zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, po dhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, e kanë siguruar kryeministrin Ramush Haradinaj se do të jetë në krye të Qeverisë deri në fund të mandatit. Zëvendëskryeministri dhe zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se këtë vit nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme dhe as rrëzim të


Qeverisë. "Në vitin 2019 nuk ka as zgjedhje të parakohshme, as rrëzim të Qeverisë e as ndryshim të partnerëve në koalicionin qeverisës. Kushdo që ka ide të këtilla dhe sheh ëndrra me sy hapur, e ka gabim", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se këtë vit ka vetëm përmbyllje të shtetndërtimit dhe marrëveshje paqeje me Serbinë si dhe punë e angazhim për zhvillimin ekonomik të vendit dhe mirëqenien e qytetarëve. Gjithashtu, Hoxhaj ka thënë se në këtë vit do të ketë ecje përpara në procesin e integritimit euroatlantik të Kosovës. "Ky është qëndrimi i vetëm i PDK-së dhe çdo deklaratë tjetër është qëllimkeq dhe synon ta dëmtojë mbarëvajtjen e punës së qeverisë dhe proceseve të rëndësishme për vendin", ka shkruar Hoxhaj. Edhe nënkryetari dhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së,

Memli Krasniqi, ka mohuar në mënyrë kategorike pretendimet e Hazirit. Krasniqi ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Haziri ka gënjyer meqë asnjëherë askush prej PDK-së nuk ka biseduar me askënd prej LDK-së për çështje të Qeverisë, aq më pak për ndërrimin e kryeministrin Haradinaj. "Lutfi Haziri ka gënjyer. Asnjëherë, askush prej PDK-së, nuk ka biseduar me askënd prej LDK-së për çështje të Qeverisë, aq më pak për ndërrimin e

kryeministrin Haradinaj. Ne jemi udhëheqës të koalicionit qeverisës dhe besimin që ia kemi dhënë Haradinajt për ta udhëhequr Qeverinë aktuale do ta mbajmë deri në fund të mandatit, në pajtim me programin qeverisës dhe marrëveshjen e koalicionit", ka thënë Krasniqi. Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, një ditë më parë pati deklaruar se partia e tij ka marrë një ofertë nga Partia

Demokratike e Kosovës, pak kohë më parë për ta rrëzuar Qeverinë e udhëhequr nga Haradinaj. Në emisionin "Pressing", të televizionit T7, Haziri ka thënë se LDK-ja e ka refuzuar këtë ofertë nga PDK-ja të cilën e kishte pasur partnere në qeverinë e kaluar. PDK-ja është udhëheqëse e koalicionit qeverisës, i cili përbëhet nga AAK-ja që mban postin e kryeministrin, Nisma Socialdemokrate, AKR-ja dhe minoritetet.

Maliqi: Kosova ka një mundësi ta plotësojë kërkesën e ShBA-së për heqjen e taksës



PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Njohësi i proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi, ka thënë se Qeveria e Kosovës e ka një mundësi elegante që ta plotësojë kërkesën e ShBA-së për heqjen e taksës 100 për qind për mallin e importuar nga Serbia, duke e arsyetuar këtë si "suspendim të përkohshëm derisa vazhdon dialogu për arritjen e marrëveshjes politike". "Ky vendim do të ishte plotësisht në pajtim me qëndrimin e Qeverisë amerikane e cila nuk konteston të drejtën e Kosovës për të vënë taksë si kundërmasë për pengesat që Serbia dhe Bosnja aplikojnë vazhdimisht për importe të mallrave nga Kosova. Suspendimi i përkohshëm nuk do të duhej ta përfshinte Bosnjën pasi me këtë shtet nuk po zhvillohet dialogu dhe kemi të drejtë që të kërkojmë reciprocitet të plotë tregtar", ka shkruar Maliqi në llogarinë e vet

në "Facebook".

Të martën në një konferencë për media kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se taksa ndaj produkteve serbe do të jetë në fuqi deri në vitin 2022 nëse nuk ka marrëveshje për njohje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka bërë me dije se ka pranuar një kërkesë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për pezullimin e taksës ndaj produkteve serbe por, pavarësisht prej kërkesës së miqve amerikanë, taksa mbetet në fuqi. "Dashurinë ndaj Amerikës e kemi pa kushte dhe besnikëria është e vërtetë. I kemi disa punë tona të shtëpisë që do t'i kryejmë për interesa tonat. S'kam ardhur këtu për përshtatje. I marr disa rreziqe për t'i arritur disa qëllime të mëdha", është shprehur ai, duke shtuar se nuk është koha e përshtatshme t'i vizitojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës për Lutjet e Mëngjesit.

Nënkryetarja e Vetëvendosjes: Ligji për pagat është mashtrim

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 JANAR - Lëvizja Vetëvendosje nëpërmjet nënkryetares Fatmire Mulhaxha-Kollçaku ka mbajtur të mërkurën një konferencë për medie në të cilën ka folur për grevën e punëtorëve të shëndetësisë. Ajo ka thënë se prej më shumë se tri javësh kirurgët në Qendrën Klinike Universitare po mbajnë një grevë me mbi 200 mjekë, të cilëve tani u janë bashkangjitur edhe Ortopedia, Institutet Paraklinike dhe Spitali i Ferizajt. Mulhaxha-Kollçaku ka theksuar se menjëherë pas formimit të saj Qeveria u siguroi që vendimin e parë të rëndësishëm ta merrte atë për rritjen e pagave për veten e saj në një masë prej 100 përqindësh. "Kjo qeveri e ka sjellë buxhetin e vitit 2019 pa e projektuar brenda tij zbatimin e Ligjit për paga dhe ligji nëse miratohet është e pamundur të zbatohet brenda këtij viti sepse

nuk ka buxhet për të", ka thënë ajo.

Mulhaxha-Kollçaku ka thënë se greva e personelit mjekësor po zhvillohet në një kohë kur po mbahen edhe grevat e minatorëve dhe ajo e punonjësve të arsimit. Sipas saj, punonjësit e sektorit publik janë thellësisht të pakënaqur me mënyrën se si po trajtohet shteti dhe punonjësit e tij nga qeveria aktuale. "E kanë nxitur këtë ortek të pakënaqësisë. Krejt kjo që po ndodh është pasojë e një vendimi të njëanshëm për rritjen e pagave për veten", ka thënë deputetja Mulhaxha-Kollçaku, duke shtuar se ashtu siç është i planifikuar, pa buxhetin përkatës, Ligji për pagat është mashtrim. "Qeveria do të duhet t'u shpjegojë mjekëve dhe qytetarëve se ku do t'i marrë mjetet financiare për plotësimin e kërkesave të tyre, në një kohë kur nuk është vendosur një buxhet për to. Pa buxhetin përkatës, ky ligj do të mbetet një copë letre", ka deklaruar Mulhaxha-Kollçaku.



Diskutohet për rekomandimet dhe komentet mbi projektligjin për administratën tatimore



A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 JANAR - Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës (ShKÇAK), në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), kanë organizuar tryezë diskutimi me biznese dhe profesionistët e kontabilitetit për të diskutuar për komentet dhe reko-

mandimet mbi Projektligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili parashihet ndryshime dhe plotësime substanciale në krahasim me ligjin paraprak.

Udhëheqësi i Departamentit të Kontrollit të Cilësisë në ShKÇAK, Arber Hoti, ka njoftuar të pranishmit mbi ndryshimet të cilat parashihen në këtë projektligj në lidhje me deklaratat tatimore, vetëvlerësimin, page-

sat, interesin, kreditimet, rimbursimet. Ai ka prezantuar disa prej rekomandimeve të bëra nga ShKÇAK-ja të cilat përfshijnë lehtësimin e veprimtarisë së bizneseve si dhe qartësimin e neneve të caktuara në legjislacionin tatimor.

Kryesuesja e Komitetit Tatimor të Odës Amerikane, Gresë Rexhepi, ka përmendur themelimin e Bordit të Ankesave i cili do ta lehtësojë veprimtarinë e

bizneseve ku ankesat e tyre tashmë do të trajtohen brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ajo ka thënë se transparenca e këtij organi do të ishte mjaft e lartë edhe përmes publikimit të vendimeve të bordit në këtë drejtim. Rexhepi ka shtuar se plotësimet dhe ndryshimet e parapara mbi projektligjin për administratën tatimore dhe procedura paraqesin një hap të rëndësishëm në legjislacionin

tatimor, megjithatë dispozita të caktuara kërkojnë qartësim të mëtejshëm.

Ndërsa kryesuesi i Komitetit Tatimor në ShKÇAK, Fahri Breznica, ka deklaruar se rëndësi e madhe duhet t'u kushtohet të drejtave të tatimpaguesve, qasjes së Administratës Tatimore të Kosovës ndaj tyre, si dhe dokumentimit dhe gjetjeve të raporteve të kontrollit.

OEK-u nënshkruan memorandum me Federatën e Odave të Emirateve të Bashkuara Arabe



PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në kuadër të Forumit Ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe që po mbahet në Dubai, ka nënshkruar memo-

randum bashkëpunimi me Federatën e Odave të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Ky memorandum ka për qëllim nxitjen e investimeve reciproke dhe avancimin e bashkëpunimit ekonomik

tregtar si dhe raporteve miqësore në mes të dy vendeve.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij memorandum synohet promovimi i bashkëpunimit në mes të komunitetit biznesor të Emirateve të Bashkuara

Arabe dhe Kosovës.

Në këtë forum ekonomik po marrin pjesë edhe biznese të Kosovës nga sektorë të ndryshëm të cilët në takimet B2B po shfaqin potencialin e tyre dhe po krijojnë lidhje biznesore me biznese nga EBA.

Në njoftimin për media të OEK-ut thuhet se ky forum duhet të shërbejë si pikënisje e bashkëpunimit reciprok me rezultate konkrete në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe fuqizimit të sektorit privat.

Qeveria i ofron mbështetje AKP-së

PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën ka zhvilluar një vizitë pune në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ku është pritur nga Bordi Drejtues i kryesuar nga u. d. i kryesuesit të Bordit, Skender Komoni dhe drejtori menaxhues i AKP-së, Valon Tolaj.

Kryeministri Haradinaj është njoftuar me aktivitetet dhe sfidat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, po ashtu udhëheqësit e bordit kanë prezantuar sfidat dhe vizionin për vitet në vazhdim, si dhe për asetet në pronësi shoqërore të cilat mund të trajtohen sipas Ligjit për Investime Strategjike.

Haradinaj me këtë rast ofroi mbështetjen e Qeverisë së



Kosovës, duke thënë se qëllimi i ardhjes në AKP është se AKP-ja është një institucion i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, menaxhon asetet që janë publike dhe, po ashtu, të

gjitha veprimet e saj mund të ndikojnë në dinamikat që po ndodhin në zhvillimin ekonomik. "Atë që kemi deklaruar, që është vit i ekonomisë, do të vërtetohet, do

të ndodhë një nxitje ekonomike edhe më e madhe sesa e planifikuar", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon

Tolaj, ka thënë se mbështetja e Qeverisë për AKP-në është shumë thelbësore dhe në funksion të kësaj ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për mbështetjen, duke shprehur gatishmërinë dhe vullnetin që, përveç obligimeve ligjore, AKP-ja të jetë bashkëpunëtoare dhe të japë kontributin e saj në funksion të zhvillimit ekonomik të konceptit që Qeveria e ka proklamuar. "Do ta japim maksimumin dhe do ta rrisim dinamikën e gjithë asaj që ne mund të ofrojmë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës, si dhe thithjes së investimeve, qoftë të jashtme apo të brendshme", ka thënë drejtori menaxhues i AKP-së, Valon Tolaj.

Fillon zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit

PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Ka filluar të zbatohet amendamenti i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, sipas të cilit, çdo market detyrohet që pranë produktit ta vendosë flamurin e shtetit të origjinës. Kështu ka

bërë me dije të mërkurën kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti. "Pas shumë insistimeve të shefit të grupit parlamentar të PSD-së, Dardan Sejdiu, në emër të

PSD-së dhe në emër të Komisionit Parlamentar, ka filluar zbatimi i amendamentit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, ku çdo market detyrohet që pranë çdo produktit ta vendosë flamurin e shtetit të

originës. Tash e tutje qytetarët nuk kanë nevojë t'i lexojnë për t'i njohur barkodet. Lehtë është për të parë se cili prodhim është i shteteve fqinje e cili është prodhim vendor", ka thënë Shpend Ahmeti.



Komuna ofron 150 shujta të ngrohta në javë për fëmijët në Handikos

PRISHTINË, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se 150 shujta të ngrohta në javë do të jenë për fëmijët në Handikos. Ai ka thënë se fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët janë në qëndrim ditë në Handikos, tash e tutje do ta kenë një shujtë të ngrohtë në ditë të përgatitur nga Kuzhina

Qendrore e Komunës së Prishtinës. "Komuna do të sigurojë rreth 150 shujta të tilla në javë, kurse Handikos do të kujdeset për transportin e ushqimit nga Kuzhina Qendrore deri në objektin e tyre. Po punojmë së bashku për krijimin e kushteve sa më të mira, për të vegjlit tanë që kërkojnë kujdes të veçantë", ka thënë Ahmeti.



Kryetari i Vushtrrisë do t'i shpërblejë me 5 000 euro ata që raportojnë për korrupsionin

Prishtinë, 16 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se ka marrë vendim që secili qytetar që do të lajmërojë keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe korrupsionin e mundshëm të zyrtarëve komunalë do të shpërblehet me shumën prej 5 000 eurosh. "Komuna e Vushtrrisë ka miratuar kodin e etikës për

zyrtarët e Komunës së Vushtrrisë si dhe Librin e proceseve për menaxhimin e parasë publike të Komunës së Vushtrrisë. Kështu, Vushtrria bëhet komuna e parë në Kosovë që aprovon këto dy dokumente të rëndësishme që rrisin transparencën dhe llogaridhënien. Në procesin e hartimit të këtyre dy dokumenteve të rëndësishme, Komuna e

Vushtrrisë është përkrahur nga USAID-i në kuadër të Projektit TEAM. Po ashtu, kam marrë vendim që secili qytetar që do ta lajmërojë keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe korrupsionin e mundshëm të zyrtarëve komunalë do të shpërblehet me shumën prej 5 000 eurosh. Qeverisja me duar të pastra është prioriteti ynë më i lartë", ka thënë Tahiri.

Ramosaj takon drejtorin e ri të shërbimeve publike, koordinohen për projektet që i presin

DEÇAN, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pritur në takim drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Izet Zenuni, me të cilin është koordinuar për punët që do të realizohen në këtë komunë gjatë këtij viti. "Ndonëse kjo drejtori gjatë vitit që lamë pas ka treguar rezultate mjaft të mira në azhurnimin e punëve të këtij dikasteri mjaft të rëndësishëm për komunën dhe qytetarët, Ramosaj ka mbajtur edhe një takim të veçantë me punëtorët e kësaj drejtorie bashkë me drejtorin Izet Zenuni. Bashkë janë

koordinuar për mbarëvajtjen e punëve edhe gjatë vitit 2019", ka njoftuar Komuna e Deçanit. Sipas kësaj komune, gjatë këtij takimi është bërë me dije se Shërbimi i Zjarrfikësve tashmë është në përfundim e sipër për t'u vendosur në objektin e vet i cili gjendet në rrugën "Elez Geci-Maxhun Berisha" në dalje të qytetit të Deçanit. Po sipas kësaj komune, Ramosaj në këtë takim ka theksuar se ky dikaster është në nivelin e duhur. Megjithatë, ai ka kërkuar që brenda vitit 2019 të ketë përkushtim më të madh për kryerjen e obligimeve komunale.



Kastrati kërkon mbështetjen e Bankës Botërore për ndërtimin e tri digave në Kamenicë

KAMENICË, 16 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka pritur në takim përfaqësuesit e Bankës Botërore, përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe përfaqësuesit e Komunës së Ranillugut, me të cilët ka diskutuar për rëndësinë e ndërtimit të tri digave në këtë komunë, përkatësisht për hidrosistemin Kikë-Kremenatë. Kastrati ka thënë se Komuna e Kamenicës është një

nga komunat më të varfra sa iu përket ujërave dhe ndërtimi i këtyre tri digave ujore ka rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët. "Shpresoj shumë që Banka Botërore do të na përkrahë në këtë projekt i cili ka vlerën dhjetëra milionëshe e që ka rëndësi të madhe për qytetarët e Kamenicës", ka thënë Kastrati. Pas takimit, i pari i komunës, së bashku me përfaqësuesit e Bankës Botërore, të MMPH-së dhe të MZHE-së vizituan nga afër lokacionet që janë caktuar për ndërtimin e këtyre digave.



A po përdoret taksa 100 për qind si arsye për rrëzimin e Qeverisë së Kosovës?



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT - KMDLNJ

Qeveria e Kosovës, si përgjigje ndaj ndërhyrjeve flagrante të Serbisë në punët ekskluzivisht të brendshme të Kosovës e për të cilat aparati burokratik i BE-së nuk pati reaguar asnjëherë, vendosi një masë tarifore për rritjen 100 për qind të taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja që fillimisht ishte masë politike e që pastaj pati efekt ekonomik; dëmtimin e buxhetit të Serbisë dhe Bosnjës sikur edhe mbrojtja e prodhuesve vendorë që filluan t'i marrin këmbët duke e rritur prodhimin. Kjo masë zbatohet edhe nga shtetet më të fuqishme siç bëri ShBA ndaj Kinës apo e bëjnë edhe shtetet brenda BE-së ndaj shteteve tjera, anëtare të BE-së, kryesisht për shkaqe politike dhe të ambalazhuar me ato ekonomike. Serbia, që nga përfundimi i luftës ka qenë eksportuesi më i madh në Kosovës dhe shumë biznesmenë kosovarë kanë ndërtuar perandorinë e tyre duke shërbyer si stërshitës të këtyre mallrave, të dyshimta dhe pa iu nënshtruar ndonjë kontrolli për caktimin e cilësisë. Duke e rrezikuar shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Pas ndërhyrjeve të vazhdueshme të Serbisë në Kosovë, e vetmja mundësi që kanë mundur ta përdorin institucionet e Kosovës ka qenë kjo taksë e cila fillimisht ishte vetëm 10 për qind për t'u rritur në 100

për qind. Kjo taksë është përkrahur në masë të madhe nga qytetarët e Kosovës sikur edhe nga institucionet kurse është kundërshtuar fuqishëm nga burokratët proserbë të BE-së, Frederika Mogerini dhe Johanes Han që, në formë të ultimatumit kanë kërkuar nga qeveria e Kosovës dhe kryeministri Ramush Haradinaj ta heq këtë masë, që, sipas tyre paraqet pengesë për vazhdimin të dialogut me Serbinë aq më parë që Vuçiqi, president i Serbisë e ka kushtëzuar vazhdimin e bisedimeve me presidentin Thaçi me heqjen e kësaj mase. Dhe, sikur është vepruar deri më tani; çka ka kërkuar Serbia ashtu edhe është bërë! Së voni doli se administrata amerikane, me një letër me 8 (tetë) pika ka kërkuar që kjo taksë të hiqet urgjentisht duke bërë presion ndaj kryeministrit Haradinaj, si kundërshtar kryesor i heqjes së kësaj takse dhe duke e kërcënuar me pasojë siç ishte mosdhënia e vizës hyrëse për SHBA. Realisht, ata që po zhvillojnë bisedime me Serbinë në një terr absolut janë më të interesuarit që kjo masë të hiqet, në mënyrë që të arrihet "një marrëveshje historike me Serbinë, detyruese", pavarësisht se mund të ketë edhe lëvizje të kufijve në dëm të Kosovës. Tash kemi zëra edhe brenda koalicionit se heqja e taksës mund edhe të rishikohet e që nënkupton se angazhohen për heqjen e kokës së Ramush Haradinajt e cila do të shkonte bashkë me taksën 100 për qind, përmes reformatimit të qeverisë

ku do të mbizotëronin ata që e përkrahin heqjen e taksës, si kusht për vazhdim të bisedimeve dhe për këtë, pandershem e përdorin si argument "kërkesën e miqve amerikanë". Këtë kërkesë fuqishëm po e përkrahin ata që tërë jetën kanë punuar kundër interesave të qytetarëve të Kosovës, ata që nuk kanë forcë e as përfaqësim politik sikur edhe ata që seksionizmin e kanë aktivitetin kryesor për inkuadrim në pushtet dhe mbetje në pushtet. KMDLNJ, edhe më herët ka deklaruar se kjo taksë, në ndërkohë, për shkak të presioneve të mëdha nga jashtë dhe lojërave të ndyra nga brenda edhe mund të hiqet apo pezullohet mirëpo, gjithashtu ka deklaruar se kjo taksë e ka arritur efektin politik, ekonomik, sensibilizues, informues, vatëdijësues, ndërgjegjësues dhe mobilizues andaj qytetarët e Kosovës, si përgjigje ndaj presioneve ndaj qeverisë së Kosovës për heqjen pa kushte të kësaj takse, duhet të bojkotojnë të gjitha mallrat nga Serbia dhe Bosnja, duke mos i blerë ato pas së cilave edhe tregtarët më të papërgjegjshëm dhe më të pandërgjegjshëm do të detyrohen të mos i importojnë ato mallra. Pra, në 100 për qind presion për heqjen e taksës për këto mallra nga këto dy shtete armiqësisht të disponuara ndaj Kosovës, qytetarët e Kosovës duhet 100 për qind t'i bojkotojnë këto mallra, deri në një situatë tjetër! Në këtë kontekst duhet të përkrahjet edhe qeveria e Kosovës si dhe kryeministri

Haradinaj, deri në një situatë tjetër sikur edhe çdo kryeministër tjetër eventual e që e mbron sovranitetin e Kosovës dhe interesin qytetarë dhe shtetërorë. Në bisedime të pakushtëzuara me Serbinë nuk duhet të pranohen kushtëzimet që po i bënë Serbia ose, si reciprocitet, edhe Kosova duhet t'i ketë kushtëzimet e saja e që e ka një mori që mund të përdoren si të tilla! Ose bisedime të pakushtëzuara, ose kushtëzimi të vendoset si standard i dyanshëm e që nënkupton se nuk do të ketë bisedime! Ndërkombëtarët duhet ta ndërprejnë zbatimin e praktikës së standardeve të dyfishta, një standard për Serbinë e 100 standarde për Kosovën! Ndërkombëtarët duhet ta pranojnë universalitetin e të drejtave të njeriut e jo të ketë të drejta të veçanta për Serbinë dhe të padrejta të veçanta vetëm për Kosovën. Qytetarët e Kosovës janë izoluar në një korridor pa dalje, e kanë të pamundësuar lirinë e lëvizjes për shkak të mosliberalizimit të vizave, prespektiva për integrim evropian është e njëjtë sikur me perspektivën që e ka Etiopia në ndërkohë që Serbisë, me një procedurë të shpejtuar po i hapen portat e Brukselit ndonjëse e ka një të kaluar shumë kriminale dhe si e tillë po sillet edhe sot duke e rrezikuar sigurinë e rajonit. Tash, pas kundërshtimit të Serbisë po diskutohet edhe mundësia e tërheqjes së vendimit për transformimin e FSK-së në Forca Mbrojtëse të Kosovës në kohën kur Serbia po bëhet bazë krye-

sore ushtarake e Ruisë në Ballkan. Nëse dikujt i duhet normalizimi i pakushtëzuar i marrëdhënieve me Kosovën atëherë ajo duhet të jetë Serbia, nëse donë të bëhet pjesë e BE-së. Kosova nuk ka pse të ngutet sepse nuk ka çka të humbë për faktin se nga BE nuk ka përfituar asgjë përveç se është detyruar të bëjë lëshime në dëm të integritetit territorial dhe sovranitetit dhe në dobi të Serbisë. Ndërkaq, nëse dikujt në këto çaste i konvenon të shkohet në zgjedhje të reja, ai është pikërisht kryeministri Haradinaj që ka fituar përkrahje të madhe për taksën e vendosur, si përpjekje modeste për demonstrim të sovranitetit shtetërorë, të munguar deri më tani dhe si kundërshtar i vendosur i lojërave me kufij që aq shumë po përflitet nga disa karrrieristë të pandreçshëm kosovarë dhe oktapodë të politikës në Tiranë e që edhe më me ëndje e përkrahin burokratët ndërkombëtarë. Ata, vendorët, po të kishin mundësi ta bëjnë reformatimin e qeverisë, pa Ramush Haradinajn, këtë do ta bënin për 5 minuta. Zgjedhjet e reja nuk i konvenojnë askujt, kërkesa për to janë bluf e jo sidomos atyre që po nguten për arrijtjen e "një marrëveshjeje historike me Serbinë duke e luajtur lojën e kufijve ...". Çdo ndryshim i kufijve ekzistues do të jetë legalizim i spastrimeve në baza etnike, eskalim të dhunës dhe shkelje brutale e të drejtave të njeriut prandaj duhet vendosmërisht të kundërshtohen!

Merkeli: BE-ja është e hapur për bisedime me Britaninë

BERLIN, 16 JANAR - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ka thënë se ende ka kohë për bisedime mes BE-së dhe Britanisë së Madhe për Brexit-in. Merkel ka deklaruar se i vije keq për vendimin e

Parlamentit britanik për të hedhur poshtë marrëveshjen të cilën kryeministrja Theresa May e kishte arritur me udhëheqësit e BE-së. "Padyshim se ne do të bëjmë gjithçka për të gjetur një zgjidhje të duhur, por jemi të gat-

shëm edhe nëse nuk arrihet një zgjidhje", ka thënë Merkel për mediet në Berlin. Sipas kancelares Merkel, ende ka kohë për negociata mirëpo Bashkimi Evropian tash po pret sugjerimet e kryeminstres britanike.



Kryeministrja britanike May përballet me votë mosbesimi

Pasi që ligjvënësit britanikë kanë kundërshtuar planin e kryeminstres britanike për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian, tani Theresa May do të përballet me mocionin e mosbesimit, por ajo synon t'i mbijetojë kësaj vote, përveç rastit kur do të rebeloheshim edhe pjesëtarë të Partisë së saj Konservatore

LONDËR, 16 JANAR - Ligjvënësit britanikë kanë kundërshtuar planin e kryeminstres britanike, Theresa May për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian, duke krijuar kaos në procesin e Brexitit dhe duke nxitur votë mosbesimi që mund të rrezojë Qeverinë aktuale.

Kundërshtimi veçse ishte pritur, mirëpo jo edhe shkalla e pakënaqësisë, pasi 432 vota kanë qenë kundër planit të kryeminstres britanike dhe 202 kanë mbështetur atë.

Ky rezultat ka treguar edhe udhëheqjen e brishtë të lideres May në Britani.

Kjo shifër njëherësh ka shënuar edhe mposhtjen më të madhe të ndonjë plani qeveritar në historinë moderne të Britanisë, transmeton AP.

Ligjvënësit do të votojnë të mërkurën në mbrëmje një mocion mosbesimi. Nëse Qeveria nuk ka përkrahje edhe tani, ajo do të ketë 14 ditë për të përmbysur rezultatin ose do të përballet me zgjedhje kombëtare.

Ndonëse May tani nuk ka shumicë në Parlament, ajo synon t'i mbijetojë kësaj vote, përveç rastit kur do të rebeloheshim edhe pjesëtarë të Partisë së saj Konservatore.

"Parlamenti ka folur dhe Qeveria do të dëgjojë", ka thënë May pas votimit, i cili ka ndodhur vetëm 10 javë pasi Britania të largohet nga BE-ja, përkatësisht më 29 mars.

May ka premtuar se do të konsultohet me ligjvënësit në hapat e ardhshëm mirëpo nuk ka dhënë detaje se çfarë planifikon të bëjë. Parlamenti në anën tjetër i ka dhënë afat Qeverisë deri në ditën e hënë që të bëjë një propozim të ri.

Mirëpo pa shumicë të qartë në Parlament, në Britani janë rritur mundësitë për shtyrje të datës së largimit, derisa politikanët të punojnë në ndonjë plan të ri ose të kthejnë vendimin sërish në duart e votuesve, duke organizuar një referendum të dytë.

"Nëse nuk mund të zgjidhet bllokada këtu në Parlament, atëherë duhet kthyer prapë te



njerëzit", ka thënë ligjvënësi i Partisë Laburiste, Chuka Umunna, i cili mbështet një referendum të dytë.

May, e cila pati shtyrë votën për planin e saj Brexit nga muaji dhjetor në janar, për faktin se i ishte bërë e qartë që nuk ka mbështetje, ka lutur ligjvënësit para votimit të 15 janarit që të punojnë bazuar në rezultatin e referendumit të vitit 2016 për largim të Britanisë nga BE-ja.

Mirëpo plani i saj është kundërshtuar nga dy palët e ndara për çështjen e Brexit-it. Ligjvënësit pro këtij procesi kanë thënë se Britania me këtë dokument do të mbetet tejet e lidhur me rregullat

e bllokut evropian, derisa politikanët pro-BE-së kanë thënë se favorizojnë lidhjet ekonomike edhe më të ngushta me Evropën. Çështje më problematike në planin e kryeminstres May ka qenë lidhur me kufirin në mes të Irlandës Veriore dhe Republikës së Irlandës dhe mundësisë për vënie të ndalesave fizike në këtë zonë, çka do të vështirësonte çështjet tregtare.

Edhe dy vjet e gjysmë pas referendumit, Britania vazhdon të mbetet e ndarë në atë se si apo nëse do të largohet nga BE-ja. Ndërkohë liderët e zemëruar evropianë i kanë bërë thirrje kryeminstres britanike që t'i bëjë

të qarta synimet e saj për të ardhmen e Brexit-it.

"Tani është koha për Britaninë që të na tregojë hapat e ardhshëm", ka thënë shefi negociator i bllokut evropian për Brexit, Michael Barnier.

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker ka thënë se kundërshtimi i planit të May ka rritur "rrezikun për largim të çregullt të Mbretërisë së Bashkuar".

Ekonomistët kanë paralajmëruar se ndonjë largim i paparashikuar nga BE-ja mund të dëmtojë ekonominë britanike dhe të krijojë skena kaotike në kufij, porte dhe aeroporte.

A do ta tërheqë Trumpi Amerikën nga NATO-ja?

WASHINGTON, 16 JANAR - Sipas një njoftimi të gazetës "New York Times", presidenti Donald Trump u tha disa herë ndihmësve vitin e kaluar se ai donte t'i tërhiqte Shtetet e Bashkuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut-NATO- e krijuar në vitin 1949.

Megjithëse publikisht presidenti Trump i është kthyer shumë herë kësaj çështjeje, ekspertët e politikës së jashtme thonë se një tërheqje amerikane do ta dobësonte aleancën dhe do të inkurajonte presidentin rus Vladimir Putin, i cili e kritikon NATO-n prej kohësh.

Prej 70 vjetësh, NATO-ja shihet si

një shtyllë e rëndësishme qëndrueshmërie nga presidentët dhe ligjvënësit amerikanë si demokratë edhe republikanë.

Por pikëpamjet e Trumpit mbi NATO-n gjatë fushatës së tij të vitit 2016 binin ndesh me këtë konsensus dypartiak.

"Më lejoni t'ju them se NATO-ja është e vjetruar, është 67-vjeçare, ose mbi 60-vjeçare. Ajo nuk merret me terrorizmin, merrej me Bashkimin Sovjetik, i cili nuk ekziston më", tha Trumpi në një rast.

Që nga zgjedhja e tij, presidenti Trump ka thënë se nuk e shikon më NATO-n si të vjetruar. Por vazhdimisht u bën trysni aleatëve evropianë për t'i rritur kontributet

e tyre, si në takimin e nivelit të lartë korrikun e kaluar.

"Për vite me radhë presidentët kanë ardhur në këto takime dhe kanë folur për shpenzimet, shpenzime të jashtëzakonshme për ShBA-në. Është bërë përparim i jashtëzakonshëm, të gjithë kanë rënë dakord që t'i shtojnë ndjeshëm kontributet. Dhe do t'i shtojnë në nivele që nuk ishin menduar ndonjëherë më parë", tha Trumpi.

Duke reaguar ndaj njoftimit të gazetës New York Times, analistët thonë se largimi i sekretarit të mbrojtjes James Mattis i ka bërë të shqetësohen për të ardhmen e NATO-s.



IKU EDHE KY VIT

*I brishtë si LIRIA
Iku edhe një ëndërr
Dhe
Kurrë më mos e qorto kafkën
Pse ngeli pa bar
Në mes të shekullit*

*Iku edhe ky vit
Pa kërkuar leje
Në kraharorin e atdheut
Që ta marrë pasaportën bio-
metrike
Për fushën e blertë*

*Iku...
Të thashë se iku
E rrudhat palë-palë
Na kanë shtruar kullën
Të bardha borë*

*Iku... Ike...
Më ofrove stuhinë
E acarin e shkriu dielli
Në prehrin tonë*

DITË ME SHI

*I mërzitshëm
Si një ditë me shi
Në një udhë të paudhë
Përshëndeteshim
Me kipcat tanë
Në një natë
Të dehur
Nga pagjumësia*

*Brinja e shkërmoqur
Më qetë gjuhën
Që s'di të buzëqesh
Me agun*

*I mërzitshëm
Si mërzia e një mërzie
Në darkën e pangrënë
Nga portreti i papërfunduar
Në ditë të stinës noprane*

NË DETIN MARMARA

*Të kërkoja tërë ditën
Në Detin Marmara
Si atë natë
Kur erdhe në këtë botë*

*Në mitrën e Urës së Gallatës
Heshta nga mrekullia
Bota u rilind
Në një mijë e një pasqyra*



SABILE KEÇMEZI-BASHA

ZJARR

*Sikur ta kisha ditur
Kurrë
Nuk do të luaja me zjarrin
Më thoshte gjyshja ime*

Unë nuk e besoja

*Nën e mbi rrogos
Flakëronte mëkati pa mëkat
Unë qeshja
Dhe shamia e bardhë
Lidhte plagët
Në Prekazin legjendë*

*Sikur ta kisha ditur
Se liria përcëllon
Bën shkumb e hi
Natën tekanjoze
E në legjendë
E shndërron gurin*

*Zjarr
Ë në zjarr digjeshin qefinët
Testamentet shkruheshin
Edhe mbi arkivol*

*Dredharake ishin rrugët
Gjarpri pa kokë sorollatej
Duke lënë lëkurën
Peng të zi
Të një historie*

*Gojë që kafshon e kollofit
Mëkatet e një bote*

*Imzot
Sa çel e mbyll sytë
Bota pësoi metamorfozë
Në zjarre
Për zjarre*

NË NYJË FATI

*Në ditën e ngurtësuar
Tjerrim fatin
E pafat
Në nyjë fati*

*Përpëlitet bari i tjerr
Në gishtat e blozuar
Dhe
Ankohet
Për kosë të topitur*

*Në Kosovë
Tirret çdo gjë
Edhe hijet
Edhe fjala e pathënë*

RRUGË

*Në viaduktin e dhembjeve
Rritet mërzia si valët
Lulet nuk kishin kohë
As të çelin*

Vjeshtë në shpirtin e dërrmuar

*Edhe më tej
Deti Marmara këndonte
vajtueshëm
Këngën e poçarit
Në gishtat e valiut shqiptar
Në komunën e Pendikut
Stamboll
Si oshtimë
Gjëmonte malli*

MË THANË

*Më thanë mbrëmë
Të kanë parë
Duke hapur kalime kufitare
Në këmishën e Atdheut
Unë qesha*

*Më thanë
Se të kanë parë
Duke kërkuar qafave
Udhët e paudha
Për një udhë me (+) pluse*

Qava me dënësë

JAM E KUQJA

*Ecim
Në mes dy urave
Të stërzgjatura
Të holla
Të kuqe all
Në maj të përgut
Fanari shndrit
Hyrje-daljet
Nga vetë bota
Qenia ime e brishtë
Bëhet pjesë e njëmijenjëta
E botës
Të dal jashtë kohe*

*Brinjët e mi
Të ndarë me vijë të kuqe
Bëhen diell
Bëhen hënë
Bëhen pjesë e romanit
Unë jam e kuqja
Pëshpërit Orhan Pamuku
Nga Stambolli i fjetur*

NË URËN E GALLATËS

*Në urën e Gallatës
Të gjitha i pashë
Me këta sy*

Qesha mavi

*Në kraharor të arnuar
Kemal Atatürk
Më ngriti barrikada*

*E pash me sytë e mi
Ditën në të sosur
Dhe
Vrapova sa munda
Për ta ndal*

*Kot
Dielli ka herë kishte perënduar*

E jashtëzakonshme

'Pushuesi' i paftuar tmerron turistët

Turistët në një plazh në Kolumbi janë tmerruar kur panë parë duke ecur në plazh një 'pushues' të paftuar. Ata nisën të iknin me vrap ndërsa një krokodil i madh hyri në plazh dhe nisi të ecte në breg. Video e filmuar tregon zvarranikun që ecën në plazh në Parkun Kombëtar Natyror Tayrona në Santa Marta. Një grup



të rinjsh shihen duke ikur me vrap në panik për t'i shpëtuar krokodilit.

BARSOLETA E DITËS



Një gjakovar, i cili i kishte blerë dy tiketa të lotarisë, pasi e fitoi 'jackpotin', në vend se të gëzohej, nisi të bërtiste:
- Çka m'u desh t'i blej dy tiketa!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,


I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



FOTO E DITES



Një shitës pakistanez i veshjeve të grave shihet duke lexuar Kuranin në dyqanin e vet. /AFP/

Në ora 17:30 "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30 "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00 "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E rrallë

I propozon së dashurës për martesë në aeroport, ajo nuk pranon dhe largohet

Nuk ka arritur dot ta nisë fluturimin një tullumbac i kuq me dedikim, me të cilin një djalosh donte ta deklaronte historinë e tij të dashurisë. Priti të dashurën e tij në aeroportin e Katanias për ta bërë propozimin e 'sikletshëm' të martesës. Kishte organizuar gjithçka me detaje: kishte blerë unazën, studiuar fjalët e duhura,



madje kishte bindur administruesit e faqes së "Facebook"-ut të "Fontanarossa" të publikonin një postim për mbështetje. Gjithçka shkoi kot: në momentin që ai u gjuhëzua dhe mes syve kuriozë të njerëzve i kërkoi të martoheshin, ajo refuzoi dhe iku.

 <p>DASHI Bëni një bashkëbisedim me veten sot për të kuptuar se kush janë gjërat që kanë vërtet rëndësi në këto çaste në jetën tuaj.</p>	 <p>DEMI Sot do të keni lëvizje shumë të forta emocionale. Kjo ditë që nisi shumë qetë mund të kthehet në një nga ditët më të paharruara për ju.</p>	 <p>BINJAKËT Këtë kohë nuk keni mundur të frenoni situata të sikletshme të provokuara nga persona që nuk kanë marrëdhënie shumë të mirë me ju.</p>	 <p>GAFORRJA Keni marrë shumë informacion nga fusha të ndryshme dhe ndiheni mjaft i mbushur shpirtërisht. Këto ditë duhet t'i kaloni më pranë familjes.</p>	 <p>LUANI Sot përfitimet tuaja nga një projekt do të jenë mjaft të dukshme. Kjo gjë do të manifestohet me batuta xhelozie nga kolegët.</p>	 <p>VIRGJËRSHA Mbase keni frikë të merrni përgjegjësi të reja mbi vete, por nëse ju pëlqejnë sfidat, duhet ta provoni. Çdo gjë e ka një të mirë nga pas.</p>
 <p>PESHORJA Nëse e ndieni veten jo shumë të mirëkuptuar nga partneri sot, mbase duhet të uleni dhe të diskutoni për ngërçin që ka lidhja juaj.</p>	 <p>AKREPI Ka shumë persona që nuk kanë besim te ju sepse nuk keni vënë asnjëherë në praktikë ato që keni thënë. Sot është dita e duhur për të ndryshuar mendim.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse e shihni çdo gjë me optimizëm dhe e ardhmja do t'ju duket shumë e mirë dhe me mjaft mundësi të reja për të shfrytëzuar.</p>	 <p>BRICJAPI Mund të jeni krenar për veten, e sidomos për pjesëtarët e familjes. Sot do të tregoni që jeni më shumë se kurrë bashkë në qëllime të mira.</p>	 <p>UJORI Sot do të merrni vendime edhe për persona të tjerë pranë jush që nuk kanë mundësi të vendosin për gjëra të mëdha në jetën e tyre.</p>	 <p>PESHQIT Dita sot do të fillojë me një surprizë të këndshme. Edhe pse nuk është ajo që prisnit, përsëri do të kënaqeni me aq sa do t'ju jepet.</p>

Vdes Carol Channing në moshën 97-vjeçare



Ylli i Broadwayit, Carol Channing, ka ndërruar jetë në moshën 97-vjeçare. Aktorja, komedianja dhe këngëtarja njihej më së shumti për rolet në filmat "Gentlemen Prefer Blondes" dhe

"Hello Dolly". Channing gjithashtu kishte sukses të rëndësishëm në Hollivud dhe se vdekja e saj pikëlloi fansat e saj. Ata e cilësuan si një pioniere origjinale të industrisë dhe si një ikonë për kohën e saj.

Kendall Jenneri do të jetë fytyra e re një kompanie për lëkurë



Kendall Jenneri do të jetë fytyra e re e markës për dermatologji "Proactiv". Për të njoftuar për partneritetin e ri "Proactiv" ajo ka postuar në rrjetet sociale një video. Modeluesen më të paguar të vitit 2018 e kanë zgjedhur për të treguar se si fytyra

dhe lëkura e pashëndetshme ndikuan në vetëbesimin e saj në të kaluarën. Natyrisht se ajo që tregohet është se "Proactiv" ia bëri lëkurën më të mirë. Për këtë Kendall ka marrë edhe shumë komente negative në rrjetet sociale.



Selena Gomez rikthehet në rrjetet sociale

Pas pothuajse katër muaj mungesë në rrjetet sociale, Selena Gomez është rikthyer. Krahas fotografive të publikuara, u është drejtuar fansave me disa mesazhe. "Ka qenë një kohë e

gjatë që ju nuk keni dëgjuar nga unë, por tani dua t'ju uroj të gjithëve një vit të lumtur të ri dhe t'ju falënderoj për dashurinë dhe mbështetjen tuaj", ka shkruar këngëtarja 26-vjeçare në "Instagram".



Will Smithi i zënë me filmin e ri

Will Smithi po e xhiron një skenë të filmit aksion. Aktori 50-vjeçar është parë duke punuar në projektin më të ri filmik "Bad Boys For Life" në Atlanta. Will është parë duke

xhiruar një skenë vrapi derisa Martini ishte aty me një fashë që mbulonte prerjen në ballin e tij. Në pamjet e xhimit Will ishte në shoqërinë e kolegut, Martin Lawrence.

Brezovica, alternativa më e mirë për të kaluar një fundjavë në borë

Dimri është një stinë shumë e bukur për të bërë disa ditë pushim. Ju mund të zgjidhni destinacionet malore, ku ka prezencë të borës. Bardhësia e saj të fal qetësi dhe paqe me vetveten. Mendimet që ju kanë pushtuar kokën rreth problemeve të përditshme zhduken dhe duket sikur mendja juaj ripërtërihet. Kështu që mos e mendoni gjatë, por nisuni drejt destinacioneve turistike. Në Shqipëri, nuk ka shumë vende për të kaluar një fundjavë, përveç Dardhës, Thethit, apo Valbonës në Tropojë. Por duhet të keni parasysh se rrugët në më të shumtën e rasteve janë të bllokuara për shkak të neglizhencës shtetërore. Akulli dhe prezenca e borës në rrugë, ju



vë jetën në rrezik. Unë do të ju sugjeroja pa as më të voglin dyshim, Brezovicën. Rruga është e mirë dhe borëpastrueset janë

gjatë gjithë kohës në gatishmëri. Në pjesën më të madhe të stinës së dimrit, Brezovica ndodhet nën pushtetin e borës.



Nisja

Qëllimi për të shkuar në Brezovicë ishte që të bëja një set fotografik, e veshur si nuse së bashku me bashkëshortin. Dukej një ide e çmendur, por gjithsesi mbetet një aventurë shumë e bukur. Mu desh që të nissha nga Tirana, rreth orës 7:00 të mëngjesit dhe kishim parashikuar që në mbrëmje të riktheheshim. Pas 90 minutave udhëtimi, ndalua në autostradë për të konsumuar mëngjesin dhe kafën. Nuk qëndruam shumë sepse kishim rrugë për të bërë. Në total

ishim 5 persona dhe çdo gjë po shkonte mirë. Biseda ishte e këndshme dhe ende nuk e dinim se çfarë na priste. Diku nga ora 13:00 mbërritëm në Prizren dhe atë ditë reshjet e borës nuk pushonin. Ndalua në një parukiere për të bërë make-up. Pasi përfundua, u nisëm drejt Brezovicës. Na thanë që nuk ishte shumë larg dhe se rrugë do të na zgjaste vetëm 50 minuta.

Surprizat e pakëndshme në rrugë

Për të gjetur rrugën drejt





Brezovicës na u desh që të pyesnim disa kalimtarë të rastit. Dalim nga qyteti dhe optimizmi vazhdonte të na shoqëronte. Ishim të lumtur që bora binte vazhdimisht sepse kishim kohë që nuk e shihnim një gjë të tillë. Mendonim për fotografitë që do të bënim dhe prisnim që do të dilnin të bukura. Por kjo ndjenjë nuk zgjati shumë. Duke iu afruar Prevallës, edhe ky destinaion turistik, nisëm që të kishim probleme me rrugën. Ecnim me 20 km në orë sepse rruga kishte borë dhe akull. Shikonim që makinat

rrëshqisnin dhe kjo na e shtonte edhe më tepër frikën, pavarësisht se automjeti ynë ishte me të katërtat rrotat aktive. Kur mbërritëm në qendër të Prevallës, u ndeshëm me një pamje të frikshme. Shumë automjete ishin bllokuar dhe dalë nga rruga. Policia kishte ndërhyrë për të normalizuar situatën, por kjo nga shkaktoi vonesa. Aty i thashë fotografit që ishte njëkohësisht edhe drejtuesi i mjetit që të ndërprisnim udhëtimin dhe fotot t'i bënim në Prevallë sepse edhe aty ishte shumë bukur, por ai nuk dëgjo. Donte që të mbërrinim në



destinacionin e vendosur më herët. Blemë zinxhirë, por tregtarët na mashtruan, sepse nuk na dhanë numrin e saktë. Është mirë që të bëni pazar sepse çmimi fillestar ishte 60 euro dhe pas disa negociatave na i dhanë 20 euro, duke na siguruar që zinxhirët ishin të postashme për automjetin tonë. Vazhduam rrugën drejt Brezovicës dhe në orën 15:00 të pasdites mbërritëm. Donim që udhëtimin ta çonim me tej, tek pista e skive, por çdo gjë ishte e bllokuar sepse trashësia e dëborës kishte mbërritur në gjysmë metri.

Realizmi i fotove

Na kishte mbetur shumë pak kohë në dispozicion. U futëm në një lokal për të pirë një çaj dhe të vishja fustanin e nuses. Pa humbur

kohë nisëm që të bënim shkrepjet e para sepse drita e diellit po na ikte. Nata nisi që të bjerë dhe ne vazhdonim që të realizonim setin. Fotot në errësirë dhe nën efektin e blicit dolën shumë të bukura dhe ne as që e kishim imagjinuar këtë rezultat. Kishim si qëllim rikthimin, por reshjet e dëborës e bënë situatën në rrugë të rënduar. Ishte e rrezikshme që të udhëtoje në ato kushte. Pyetëm për të gjetur hotel dhe çmimet ishin nga më të ndryshmet, nga 70 -20 euro nata. Është mirë që të mos nxitoheni kur të zini dhomën sepse edhe këtu mund të negocioni çmimin. Ushqimi është shumë i përballueshëm dhe i bollshëm. Dhomat janë shumë të ngrohta. Frika nga shoqëroi gjatë gjithë ditës, por pavarësisht kësaj ishte pamja e natyrës ishte si në përral-

la. Bora kishte zbardhur çdo gjë. Qetësia ishte ajo që mbizotëronte kudo.

Habia e njerëzve teksa me shikonin të veshur nuse



Të nesërmen vazhduam setin dhe reshjet e borës nuk kishin ndaluar për asnjë moment. U veshja sërish nuse dhe dolëm jashtë. Përballja me temperaturat e ulta nuk ishte e lehtë, por nuk u dorëzova. Syri të kapte grupe njerëzish të lumtur që qeshnin me njëri-tjetrin. Ishin veshur trashë dhe teksa më shikonin mua të veshur nuse, habiteshin se si e përballoja të ftohtin. Kërkonin që të bënim foto me mua dhe nuk i ndaloja. Deri nga mesi i ditës qëndruam në Brezovicë. Më pas nisëm rikthimin. Ndalnim herë pas herë që të bënim shkrepje me aparat. Çdo vend na dukej i bukur, syri nuk ngopje së pari një mrekulli të tillë. Ishte shumë ftohtë, por nuk u dorëzuam për asnjë moment. Përveç fotografive bëmë edhe një klip.

Rikthimi

Rikthimi nuk ishte shumë i vështirë, ndonëse duhet të tregofshim të kujdesshëm. Borëpastrueset në Kosovë e mbanin rrugën të zhbllokuar. Nga ora 18:00, shkuam në Kalimash. Bora vazhdonte të binte me intensitet dhe rruga ishte shumë e rrezikshme. Kishte akull në rrugë dhe na u desh që të ulnim shpejtësinë. Kur mbërritëm në Laç, rruga ishte pastër sepse nuk binte dëborë. Në Tiranë u rikthyem rreth orës 20:00.

(Silvana Muça / gazeta-Shqip.com)



		1 Autor: Gazmend Morina - BENI		AKTORI AMERIKAN NË FOTO 1	KAFSHË E VOGËL HELMUESE ME NGJYRË TË ZEZË (shq.)	NDËRMARRJE E MADHE INDUSTRIALE E MEKANIZUAR (shq.)	PAJTUESHMËRI (krah.)	SHKOJ, ECI (bised.)	DY BASHKËTINGËLLORE	INDIANA					
		DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË													
		I PËRPIKTË, I SAKTË, I PAGABIM													KËNGËTARJA DHE AKTORJA BRITANIKE NË FOTO 2
		BIMË BARISHTORE NJËVJECARE ME KOKRRAT E SË CILËS BËJMË PILAF (shq.)								BASHKËTINGËLLORE SUPER MODELJA SPANJOLLE PEREZ					
		NËNNDARJE E NJË KODI A E NJË RREGULLOR-EJE (shq.)								BASHKË, TOK RRUZULLI I TOKËS					
		VËLLAI I MADH							MODELJA & AKTORJA ... RAFAELI BRAGA, AKADEMICA						
RENS ISTVUD						VEGËL MUZIKORE ME FRYMË ARKIVI I FILMAVE									
EPOKA E RE	PEMË E VENDEVE TË NGRORHTA	GADISHULL NË EVROPË	RRJETËZA E SYRIT	INTERNATIONAL LEADERSHIP ASSOCIATION	BASHKËTINGËLLORE TROYES	AI QË VRET DIKË NË MËNYRË MIZORE (pashq.) KËNGËTARJA AUSTRALIANE IMBRUGLIA (shqip.)					ZANORE	SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTRËMBËRIMIN E ESHTRAVE	ISH FUTBOLLISTI YNË I NJOHUR ... VOKRRI	KONFERENCA ME KARAKTER NDERKOMBËTAR SHTET NË AZI	
ZË I THELLË MASHKULLI NË MES TË TENORIT DHE BASIT (shq.)															
THIRRJE QË I BËHET MASËS					FUTBOLLISTI BRAZILIAN ... ALVES (Barcelona)						DY ZANORE IRISH REPUBLICAN ARMY			AKTORI YNË ZHITOPOTOKU AZEM MAKSUTAJ	
GJENDJA FIZIOLOGJIKE E QENIEVE TË GJALLA					QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shq.) ZANORE						LYERJA ME LLAK E PËRZIEJ, E TRAZOJ				
KYÇI, NYJA				FRIKACAKE, IKACAKE ANDORA										POPULL (turq.) ILION LIKA	
MJET SHPËRTHYES					GJERMANI I VJETËR SHKRIMTARI I NJOHUR AMERIKAN HEMINGUEJ									SHKRONJA XXVIII BOLTON, IPSVICH	
PJATA				GJINI I KRIJIMTARISË LETRARE NË FORMË TREGIMI 3.14 (mat.)							VEPRIMTARI I SHQUAR KURTI (shq.) FILM I REGJISORIT JAMES CAMERON				PJESË E VITIT (sh.shq.)
EPOKA E RE	PJESË E MEKANIKËS QË STUDIËN LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE	BANORËT E KRYEQYTETIT TË KANADASË	PATTERN RECOGNITION RECEPTORS QENGJ I BUTË			SULM MONZA								NEGRI, ZEZAK (bised.) METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT (shq.)	BASHKËTINGËLLORE AKTORJA ME FAMË BOTËRORE XHESIKA ...
MBIZOTËRIM														FUTBOLLISTI ... RAMIRO CORDOBA (Inter) DY ZANORE	NËNAT
AKTORJA E VJETËR ... RINA				ELTON ORLANDES ZANORE		PIKTORI ... VALLA (shq.) PUSIA (sh.shq.)								PJESË E LIMANIT KU QËNDROJNË ANIJET (shq.) JETËSHKRIME	
→					FJALË POUHUESE ELECTRONIC MEDICAL RECORD			PLANETI YNË BOR, INDIUM						"B" në mes të dy "N" SHTET NË EVROPË	
BIMË E VISEVE TROPICALE AKTORJA HOLLYVUDIANE GARDNER				DEM SHKRIMTARI ... ZOLA										PELLGU I HAPËT PËR TË GRUMBULLUAR UJË MJET PËR SITJE	DY ZANORE VENDËS, RRENJËS
AKTORJA & KËNGËTARJA AMERIKANE WINNINGHAM					EMËR I VJETËR PËR EGJIPTIN SHKRONJA TË NJËJTA									SËPATË E VOGËL ME TEH TË GJERË AKTORJA E NJOHUR DEMI (shqip.)	TRIERI NJË (ang. orgj.)
IDRIZ SEFERI			LUFTËTARI PËR TË DREJTAT E ZEZAKËVE LUTHER KING NATRIUM						QYTETI ITALIAN I MODËS KANDY AMBER						IGLI TARE
SHTET NË AFRIKËS					ARTIOLA TOSKA SHKRONJA XIX			NË ÇFARË VENDI						HOVI, VRULLI BASHKËTINGËLLORE	
KLUB FUTBOLLI ITALIAN								AKTORI YNË ... ISLAMI						EMËR YNI MASHKULLI	

Lexues të nderuar, për vërejtje dhe sugjerime mund të shkruani në: fjalekryqi_beni@yahoo.com & gazmend78@hotmail.com
 S. DOMINIM, IVAN, EMAT, ITA, EO, ESATI, MOLI, ANANAS, PO, TOKA, NBN, AVA, TER, BASEN, AP, MARE, MISIRI, LATA, T, IS, MARTIN, MLANO, KEMIN, AT, KU, ELANI, ATALANTA, ARD, ISET.
 ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: LAURIMI, EKZAKT, ORIZI, Ç, NENI, ME, APA, BAR, RI, BORI, D, KATIL, BARITONI, ANKARAJA, AP, DAN, AO, ADEM, JETA, TONI, LAKIMI, ANI, IKATRE, MILET, MINA, ALEMANI, T, NI, ENA, EPIKA, ALBANI, PRR, ATAK, IZI.

Balili në gjykatë, ja për çfarë akuzohet “Eskobari i Ballkanit”!

Një ditë para se Gjykata e Krimeve të Rënda t'i komunikojë masën e sigurisë Klement Balilit, zbardhen edhe akuzat e prokurorisë ndaj atij që cilësohet si “Eskobari i Ballkanit”.

Ky i fundit është dorëzuar ditën e djeshme në Delvinë, i shoqëruar nga familjarët e tij dhe në prani të autoriteteve më të larta policore, mes të cilëve edhe kryepolici i vendit Ardi Veliu.

xGazeta “Shqip” mëson se akuzohet për disa vepra penale, nga trafiku i lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim, e deri tek pastrimi produkteve të veprës penale.

Ish-kreu i Transporteve të Sarandës akuzohet gjithashtu për refuzim të deklarimit, deklarim të rremë dhe fshehje e pasurive dhe interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë. Dyshohet se gjatë periudhës që ka qenë në këtë post, Klement Balili ka fshehur të ardhurat e siguruar nga trafiku i drogës në drejtim të Greqisë.

I pagëzuar si “Eskobari i Ballkanit”, ndaj tij nuk është ngritur ende, të paktën deri më

tani, akuzat e krijimit dhe drejtimit të një grupi të strukturuar kriminal, por vetëm ajo e pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal.

Balili është i kërkuar edhe në Greqi, aty ku ka ushtruar aktivitetin e tij të paligjshëm. Në vitin 2016, Gjykata e Athinës ka caktuar ndaj tij masën “arrest me burg” dhe pas kësaj është lëshuar urdhri ndërkombëtar për ta arrestuar.

Duke qenë se Balili nuk mund të ekstradohet në Greqi për shkak të një vakumi ligjor, ai do të gjykohej nga Gjykata e Krimeve të Rënda shqiptare. Këtë fakt e ka konfirmuar dhe Ministri i Brendshëm Lleshaj, i cili deklaroi dje se në këmbim të vetëdorëzimit, shteti shqiptar i ka ofruar Balilit “një proces të drejtë ligjor”.

Por si ra Greqia në gjurmë të Balilit? Në prill të vitit 2016, autoritetet greke kishin arrestuar dy shqiptarë nën drejtimin e një skafi ku po transportonin një sasi të konsiderueshme kanabisi.

Pikërisht nga përgjimet telefonike të tyre është zbuluar edhe emri i Balilit, i cili në maj 2016



është shpallu në kërkim nga Athina.

Por vetëm pas një viti dosja do të

përkthehej dhe do të transferohej tek autoritetet shqiptare, të cilët të nxitur edhe nga agjencia

amerikane kundër drogës, DEA, përpiluan dosjen ndaj “Eskobarit të Ballkanit”.

Kanabisi, mjafton një cigare për të ndryshuar trurin e të rinjve

Disa të thithura me cigare hashash janë të mjaftueshme për të ndryshuar strukturën e trurit tek adoleshentët. Kjo është ajo çfarë del nga një studim i publikuar në “Journal of Neuroscience” nga hulumtuesit në Universitetin e Vermontit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një rritje anormale në vëllimin e lëvores cerebrale, në korrespondencë me fushat e lidhura me emocionin dhe kujtesën, është vënë re për herë të parë tek disa 14-vjeçarë, të cilët kishin konsumuar kanabis në mënyrë sporadike.

Rezultati hap pyetje të reja për legalizimin e substancës për qëllime rekreative. “Me sa duket vetëm konsumojnë një ose dy cigare për të ndryshuar vëllimet e materies gri tek këta adoleshentë të rinj”, vuri në dukje psikiatri, Hugh Garavan.

Ata analizuan të dhënat që lidhen me zhvillimin e trurit dhe

shëndetin mendor të të rinjve të anketuar në Britaninë e Madhe, Irlandë, Francë dhe Gjermani në kuadër të projektit evropian “Imagen”. Studimi përfshinte 46 katërmbëdhjetë vjeçarë të cilët kishin përdorur kanabis vetëm një herë ose dy herë. Në trurin e tyre, del se tek ata janë zbuluar rritje anormale në vëllimin e zonave të caktuara të materies gri të ndjeshëm ndaj ‘cannabinoidëve’: ndryshimet më të rëndësishme janë vërejtur në ‘amygdala’ (i lidhur me frikë dhe proceset e tjera emocionale) dhe hippocampus (e lidhur me kujtesën dhe me hapësirën).

Mbetet të kuptohet se çfarë do të thotë shtrirja dhe rëndësia e këtyre ndryshimeve strukturore. Zakonisht në adoleshencë, truri i nënshtrohet një “shkurtimi” të lidhjeve nervore, i cila zvogëlon vëllime: prandaj është e mundur që kanabisi të pengojnë këtë proces.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BARCELONA V LEVANTE

1

ESPANYOL - VILLARREAL

GG

REAL SOCIEDAD - REAL BETIS

3+

Mospërfundimi i punimeve në palestër, brenga e vetme para 'Final 8'

Drejtesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe të KB Rahoveci kanë apeluar te Komuna e Rahovecit dhe Ministria e Sportit që të përfundojnë sa më shpejt punimet në palestrën në Rahovec, pasi aty do të zhvillohet "Final 8" e Kupës së Kosovës në basketboll nga data 27 shkurt deri më 3 mars



EPOKA E ENJTE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryetari i KB Rahoveci, Bekim Hoxha, është shprehur shumë i lumtur se Federata e Basketbollit të Kosovës i ka besuar skuadrës së Rahovecit organizimin e "Final 8" të Kupës së Kosovës në basketboll. Ai ka kërkuar nga institucionet lokale dhe qendrore që ta përkrahin klubin për kryerjen e punimeve në palestër. "Ne jemi shumë të lumtur që FBK-ja na ka besuar organizimin e 'Final 8' të Kupës së Kosovës. Ne si klub jemi zotuar para FBK-së se do t'i kryejmë të gjitha obligimet që dalin nga Udhëzuesi për Organizim të 'Final 8', si dhe nga kontrata, dhe kështu do të organizojmë një spektakël që do të mbahet mend gjatë në basketbollin e Kosovës. Shfrytëzoj rastin të bëj apel tek institucionet tona lokale dhe ato qendrore që të na përkrahin në këtë fazë përfundimtare të punimeve në palestër në mënyrë që të kryhet puna dhe ne të fillojmë përgatitjet intensive për organizimin e kësaj ngjarje madhështore", ka thënë Hoxha pas nënshkrimit të kontratës.

"Final 8" i Kupës së Kosovës do të organizohet prej 27 shkurtit deri më 3 mars 2019, ndërsa sekretarja e përgjithshme e Federatës së Basketbollit, Elvira Dushku, ka apeluar që të kryhen sa më shpejt punimet në palestrën të cilën FBK-ja do ta inspektojë në fund të këtij

muaji. "Ne bëjmë apel te Komuna e Rahovecit dhe te Ministria për Kulturë, Rini e Sport, që pjesa e mbetur e pakryer në palestrën në Rahovec të përfundojë sa më shpejt që është e mundur, sepse në fund të muajit janar Federata do ta bëjë inspektimin përfundimtar të palestrës në mënyrë që ta bëjë një analizë të gjendjes së përgjithshme para punës intensive të 'Final 8' të Kupës së Kosovës. Ne po besojmë që KB Rahoveci do t'i kryejë të gjitha zotimet e marra dhe kështu do të jemi të gatshëm për një spektakël të basketbollit në qytetin e Rahovecit, sepse me të vërtetë si klub e meriton dhe e ka merituar që kjo palestër të kryhet shumë herët, duke marrë parasysh organizimin dhe përkushtimin e tyre", ka thënë Dushku.

Sekretarja e FBK-së më pas foli edhe për aktivitetet që e presin basketbollin e Kosovës në muajin shkurt. "Muaji shkurt tash e sa vjet është muaji i shumë aktiviteteve të FBK-së, duke filluar nga ndeshja Kosova - Rumania në kuadër të parakualifikimeve për 'Eurobasket 2021', pastaj në kuadër të 'Final 8' të Kupës së Kosovës do të organizohet FIBA SCOD Camp për gjyqtarët e rinj, FIBA Camp për gjyqtarët Potencialë për Thirrje të FIBA-s, ku këtu do të kemi 3 gjyqtarë nga Kosova, 1 nga Kroacia, 2 nga Franca, 1 nga Mali i Zi, 1 nga Turqia dhe 1 nga Sllovenia. Krahas këtyre aktiviteteve, FBK-ja tanimë e ka bërë

traditë që në kuadër të 'Final 8' të Kupës së Kosovës ta organizojë edhe Kuvendin e Punës, i cili do të mbahet më 3 mars në Rahovec. Të gjitha këto aktivitete do të jenë nën mbikëqyrje të FIBA Evropës. Kjo e fundit do të ketë përfaqësuesit e pranishëm në kuadër të 'Final 8', në krye me drejtorin e Departamentit të Gjyqtarëve në FIBA Evropë, Davorin Nakiq", ka deklaruar Dushku.

ORARI I TË GJITHA NDESHJEVE

Më 27 shkurt takohen:
14:00 Bashkimi - Prishtina (gjysmëfinalja në konkurrencën e femrave)
16:30 Z Mobile Prishtina - Trepça
19:00 Rahoveci - Don Bosko

Më 28 shkurt takohen:
14:00 Vëllaznimi - Istogu (gjysmëfinalja e Kupës së Ligës së Parë)
16:30 Golden Eagle Ylli - Feronikeli
19:00 Ponte Prizreni - Bashkimi

Më 1 mars takohen:
14:00 Feronikeli - Penza (gjysmëfinalja e Kupës së Ligës së Parë)
16:30 Gjysmëfinalja e Parë e Kupës së Kosovës
19:00 Gjysmëfinalja e Dytë e Kupës së Kosovës

Më 3 mars takohen:
12:00 Finalja e Kupës së Ligës së Parë
14:30 Finalja e Kupës së Kosovës - Femrat
17:00 Finalja e Kupës së Kosovës - Meshkujt

SHKURT

Feronikeli rikthen Konen

Skuadra e Feronikelit e ka rikthyer futbollistin Ben Hamed Kone i cili në janar të vitit të kaluar i ishte bashkangjitur "Niklit", por në muajin maj ishte larguar në drejtim të Zvicrës. Kone do të t'i bashkohet menjëherë klubit në stërvitje, me ç'rast edhe do të udhëtojë së bashku me pjesën tjetër të ekipit për përgatitje në Turqi. Feronikeli dhe Prishtina janë dy skuadrat favorite në garën për titull të kampionit në IPKO Superligë, por edhe favoritë në garën e Kupës.

Muqiqi vazhdon me Prishtinën

Portieri Alban Muqiqi ka vendosur ta vazhdojë qëndrimin në Klubin e Prishtinës edhe për një vit e gjysmë. Muqiqi me Prishtinën i ka 42 paraqitje zyrtare dhe ai vazhdon t'i qëndrojë besnik klubit, megjithëse kohët e fundit nuk ka pasur paraqitje si titullar. "Vendosa të vazhdoj të luaj për Prishtinën pasi që këtu jam rritë dhe ndihem si në shtëpinë time. Kisha kontakte edhe nga klube të tjera, por zgjedhja për të vazhduar me klubin tim ishte shumë e lehtë", ka thënë Muqiqi.

Rexhepi, lojtar i ri i Vushtrrisë

Skuadra e Vushtrrisë ka arritur marrëveshje për transferimin e sulmuesit Alban Rexhepi nga Skuadra e Llapit. 23-vjeçari nga Gjilani është pjesë e shkollës së Klubit të Futbollit Drita nga Gjilani, debutues në moshën 17-vjeçare në ekipin e Dritës, për ta vazhduar karrierën në ekipet e tjera KF Gjilani, KF Laçi nga Shqipëria, KF Ferizaj dhe, së fundi, pjesë e KF Llapit.

Zeneli në mesin e asistuesve më të mirë në Evropë

Reprezentuesi i Kosovës, Arbër Zeneli, është në mesin e 10 asistuesve më të mirë në Evropë, vetëm katër asistime larg vendit të parë. Zeneli është duke e shijuar sezonin e tij më të mirë me Heerenveenin në ligën elitare holandeze, Eredivisie, që prej transferimit të tij nga Elfsborgi tre vjet më parë. 23-vjeçari është ndër lojtarët më me ndikim në skuadrën e tij deri tani këtë sezon, pasi është përfshirë në shumicën e golave të shënuara nga Heerenveni. Përveç tri golave të shënuara, ai ka dhuruar tetë asistime në 16 ndeshje deri tani.

Gjimshiti te Beshiktashi për 500 mijë euro

Nga Seria A në Superligën turke. Berat Gjimshiti, raportojnë mediet italiane, është larg Atalantës dhe shumë pranë Beshiktashit. Skuadra turke ka bindur mbrojtësin kuqezi dhe mungon vetëm zyrtarizimi i këtij transferimi. Gjimshiti i skadon kontrata këtë verë dhe skuadra turke po përfiton për ta transferuar lojtarin që tani. Atalanta kërkonte 1 milion euro, por Beshiktashi u tregua i gatshëm ta priste verën për ta bërë pjesë të klubit si lojtar të lirë. Por, kur italianët e panë situatën në disfavorin e tyre, janë dorëzuar dhe kanë ulur çmimin në 500 mijë euro.

Mavraj: Te Hamburgu nuk më trajtuan siç duhet

INGOLSTADT, 16 JANAR - Mbrojtësi dhe kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, për mediet gjermane ka folur për periudhën e trazuar që kaloi te Hamburgu. Mbrojtësi 32-vjeçar

pranoi se te ish-skuadra e tij e kanë trajtuar shumë keq dhe se ishte i zhgënjyer me periudhën që kaloi aty. "Nuk kam dëshirë t'u rikthehem historive të mbyllura, por te Hamburgu

nuk më kanë trajtuar asnjëherë siç duhet. Nuk kemi pasur probleme madhore, por fjala ime nuk dëgjohej asnjëherë dhe nuk më trajtonin siç duhet. Gjithsesi, është një kapitull i

mbyllur dhe tani jam i lumtur që jam pjesë e Ingolstadtit. Dua t'i falënderoj drejtuesit e Hamburgut për mundësinë që më dhanë, por vetëm kaq", ka thënë Mavraj.



Golden State merr kryesimin në Perëndim. Lakersat fitojnë edhe pa LeBronin

DENEVER, 16 JANAR - Golden State ka fituar 142-111 ndaj Denverit, në ndeshjen në mes të dy skuadrave kryesuese të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Sukses që ka ngjitur ekipin kampion në vendin e parë në këtë kah të NBA-së, duke bërë rokadë me Denverin, tashmë i dyti. Ndeshja u dominua dhe fitua pa shumë probleme nga basketbollistët e Warriorsit, që treguan se atëherë kur duhet, nuk gabojnë. Denveri nuk përfitoi nga faktori fushë, duke zhgënjyer para fansave, ndërsa për miqtë Curryt e Thompsonit realizuan nga 31 pikë, mbështetur edhe nga Duranti me 27 pikë, një trio që shkëlqeu në fushë. Golden State vendosi edhe rekordin e 51 pikëve të realizuara në periudhën e parë në NBA. Në Perëndim fiton edhe skuadra e Lakersit, që rikthehet te fitorja, duke mundur 107-100 Chicagon. Pjesa e parë ishte e ekuilibruar, me të dyja ekipet që luajtën fort për fitore, por në të dytën kali-



fornianët bënë diferencën në fushë, me Ballin që realizoi 19 pikë. Pa problem fiton edhe skuadra e Milwaukeees, që mundi 124-86 Miamin, duke u ngjitur në vendin e dytë në Lindje. Shtatë lojtarë të Bucksit realizuan mbi 10 pikë, me të zakonshmin Antetokounmpo që e mbylli me një "triple double", 12 pikë, 10 rebounde e 10 asistime. Në ndeshjet e tjera të luajtura sot, skuadra e Indianas fitoi 131-97 ndaj Phoenixit,


ndeshje në sens unik, dominuar nga vendësit, me Bogdanoviçin e Evansin që realizuan nga 20 pikë. Zhgënjën skuadra e Oklahomës, që u mund 142-126 nga Atlanta, ndeshje spektakolare dhe emocionuese. Collins me 26 pikë ishte shënuesi më i mirë i Atlantës, duke i bërë të pavlefshme 31 pikë e 11 asistime të Westbrookut. Fiton edhe Philadelphia, që mundi 149-117 Minnesotan, me Embiidin që realizoi 31 pikë e 13 rebounde.

REZULTATET

Indiana - Phoenix	131-97
Philadelphia - Minnesota	149-107
Atlanta - Oklahoma	142-126
Milwaukee - Miami	124-86
Denver - Golden State	111-142
Lakers - Chicago	107-100

Çështja 'Mayorga', akuzat ndaj Ronaldos në një fazë të re

LAS VEGAS, 16 JANAR - Çështja Mayorga - Cristiano Ronaldo është pasuruar me zhvillime të reja. Avokati i vajzës, që akuzon sulmuesin e Juventusit për përdhunim në vitin 2009 në Las Vegas, Lesli Mark Stovall, ka mbërritur tashmë në Londër, për të zhvilluar një takim me Jasmine Lennard, një nga ish të dashurat e futbollistit, me këtë të fundit që kishte deklaruar se zotëronte prova kompromentuese për Ronaldon. Takimi u konfirmua nga një prej anëtarëve të zyrës ligjore "Stovall&Associates", por nuk u dhanë detaje në lidhje me temën e diskutimit. Ditë më parë, Jasmine Lennard, ish-konkurrente e "Big Brother"-it në Britani, e përkufizoi Cristiano



Ronaldon si një "djalë mamaje milioner, metroseksual, psikopat e me një personalitet bipolar". Ajo shtoi në deklaratën e saj se ishte gati që ta ndihmonte Kathryn Mayorgën në betejën ligjore me Ronaldon për përdhunim, duke përmendur edhe ekzistencën e provave kundër tij.

Avokati i Mayorgës, Stovall, iu përgjigj menjëherë këtij apeli për ta nisur betejën në gjykatë, në mënyrë që ta anulojë akordin e firmosur në atë kohë nga klientja e tij dhe futbollisti portugez për mospublikimin e ngjarjes dhe për të vijuar me goditjet e tij ndaj luzitanit.

SHKURT

Sadiku: Lugano, dashuri që nuk mbaron kurrë

"Disa dashuri nuk mbarojnë, ato marrin kthesa të pafundme dhe më pas rikthehen sërish", janë fjalët e para të Armando Sadikut pas rikthimit te Lugano. Në një intervistë për mediet zvicerane, sulmuesi shqiptar shprehet i lumtur për këtë transferim. "Jam i lumtur të rikthehem te Lugano. Ishin muajt të vështirë për mua, por tani jam në gjendje të mirë psikologjike dhe dua t'i jap gjithçka skuadrës. Kam pesë muajt që bëj terapi për gjurin dhe jam stërvitur për një muajt me Levanten. Tani jam gati të luaj. Shpresoj të jem në nivelet që kam qenë dy vjet më parë, kam folur me disa njerëz në klub dhe ambienti është fantastik. Me siguri jap maksimumin. Përvoja jo aq e mirë në Poloni dhe Spanjë më dha më shumë forcë dhe më shtyri të rikthehem sërish në nivelet më të larta. Falënderoj klubin që bëri këtë përpjekje të më rikthejë këtu", ka thënë Sadiku.

Giroudi në planet e Barçës

Sulmuesi i Chelsea, Olivier Giroud, është në planet e Barcelonës. Lajmi është bërë me dije nga gazeta spanjolle "Sport". Drejtuesit e Barçës nuk dëshirojnë të jenë vetëm me një qendërsulmues në skuadër, prandaj synimi i tyre është transferimi i sulmuesit francez. Ish-sulmuesi i Arsenalit ka kontratë me Chelsean deri në fund të këtij kampionati.

Valencia interesohet për "Chichariton"

Valencia është e interesuar për transferimin e sulmuesit Javier Hernandez i njohur si "Chicharito". 30-vjeçari që ka qenë pjesë e Manchester Unitedit dhe Real Madridit nuk është i kënaqur me hapësirën që ka te West Ham Unitedi, prandaj kalimi te Valencia duket një zgjidhje e mirë.

Di Maria: Në United dështova për shkak të Van Gaalit

Futbollisti i PSG-së, Angel Di Maria, beson se trajneri Louis van Gaal është fajtor për dështimin e tij te Manchester Unitedi. Argjentinasi kishte kaluar te Djajtë e Kuq më 2014 për 59.7 milionë dollarë, por ishte larguar vetëm pas një viti në drejtim të Paris Saint-Germainit. "Qëndrova vetëm për një vit. Nuk ishte periudha më e mirë e karrierës sime, ose më mirë të them nuk qeshë lejuar ta kaloj kohën më të mirë aty. Kishte komplikime me trajnerin atëbotë. Por, falë Zotit, pata mundësinë të vij në PSG dhe të demonstroja sërish se kush isha", ka thënë di Maria për "France Bleu".

Nadali dhuron spektakël, Kerberi e Kvitova avancojnë në raundin e tretë

Tenisti spanjoll Rafael Nadal, numri dy në botë, ka avancuar në raundin e tretë të grand slamit të Australian Openit, pas fitores 3-0 (6-3, 6-2) ndaj australianit Matthew Ebden. Një ndeshje e dominuar dhe fituar pa shumë probleme nga Nadali, që pati epërsi në të tre setet, duke konfirmuar se problemet fizike të ditëve të para të janarit tashmë janë lënë pas. Në raundin e tretë ka avancuar edhe tenisti bullgar Grigor Dimitrov, që mposhti 3-1 (6-3, 6-7, 6-3, 7-5) uruguianin Pablo Cuevas, ndeshje që dhuroi edhe emocione. Amerikano-latini duelloi fort, por e pati të pamundur ta mposhtë tenistin ballkanas. Te femrat, në ndeshjet e fundit të ditës së tretë të Australian Open, spikat fitorja e ish-kampiones së këtij turneu, gjermanes Angelique Kerber. Ish-numri 1 në botë mundi 2-0 (6-2, 6-3) brazilianen Beatriz Maia, një fitore e lehtë e tenistes gjermane. Fiton edhe tenistja çeke Petra Kvitova, që mposhti po 2-0 (6-1, 6-3) rumune Irina Begu, ndërsa Belinda Bencic e Zvicrës fitoi 2-1 ndaj kazakes Yulia Putintseva (7-5, 4-6, 6-2), duke avancuar më tej.



*** FTESË PËR OFERTË ***

Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Duke qenë se, në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit funksionon Qendra Informativë e Sigurimit, Sigurimi Kufitar dhe të tjera, BKS i fton të gjithë të interesuarit të paraqesin ofertat mbi tenderin si më poshtë;

"Shtypja e policës TPL, TPL+ dhe policës të Sigurimit Kufitar për Byronë Kosovare të Sigurimit dhe Industrinë e Sigurimit".

Kushtet për ofertim;

- Oferta financiare,
- Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e biznesit dhe TVSH-së,
- Eksperienca e ofertuesit me punë të ngjashme (së paku dy vitet e fundit),
- Garancioni për shërbimin e ofruar, si dhe
- Kushtet tjera të përcaktuara në dosjen e këtij tenderi.

Oferta duhet të paraqitet brenda datës dhe orës së mëposhtme:

25 Janar 2018, ora 13:00 – 14:00

Me zarf të mbyllur, në kopje të printuar dhe jo nëpërmes e-mailit, tek:

Byroja Kosovare e Sigurimit

Rr. Lidhja e Pejës pn/ Magjistranja Prishtinë – Fushë Kosovë

Poashtu,

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes e-mailit: bks@bks-ks.org

Ju falënderojmë sinqerisht për interesimin që tregoni për të bashkëpunuar me Byronë Kosovare të Sigurimit dhe mbesim me shpresë se do t'i respektoni të gjitha kërkesat si më sipër të paraqitura nga ana jonë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bislim Zabeli shpall te pavlefshme diplomën e shkollës profesionale QAP Mitrovicë.

► Bujar Bushi shpall te pavlefshme deftesat e klasës 10,11,12,13 dhe diplomën e SH.M.L "Dardania" Hani i Elezit.

► Unë Fahri Avdiu distancohem nga djali im Bledi Fahri Avdiu dhe nuk marr asnjë përgjegjësi dhe asnjë obligim për veprat e tija, si borgje, vjedhje apo marrje të parasë me fajde. Si dhe njëkohësisht kërkoj nga ju të dëmtuarit që mos të më kontaktoni as në telefonin tim. Me respekt Fahri Avdiu.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.



NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se kompania "K.F.F Hajvalia" SHPK me seli ne Prishtinë ka marre vendim te shuaj biznesin me numer te regjistrimit 810091322 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "K.F.F Hajvalia" D.o.o u Prishtini, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810091322 i ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze i potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "K.F.F Hajvalia" L.L.C in Prishtini has come to the decision to quit its business with registry: 810091322. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se kompania "Portali www.Koalb.com" SH.P.K. me seli ne Prishtinë ka marre vendim te shuaj biznesin me numer fiskal 601609889 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "Portali www.Koalb.com" D.o.o u Prishtini, doneo odluku da ugasi biznis sa fiskalnim brojem 601609889, i ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "Portali www.Koalb.com" L.L.C in Prishtina has come to the decision to quit its business and with the fiscal number 601609889. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se kompania "BETA-POLL" SH.P.K. me seli ne Prishtinë ka marre vendim te shuaj biznesin me numer fiskal 601710496 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "BETA-POLL" D.o.o u Prishtini, doneo odluku da ugasi biznis sa fiskalnim brojem 601710496, i ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "BETA-POLL" L.L.C in Prishtina has come to the decision to quit its business and with the fiscal number 601710496. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se kompania "KOSOVA RECYCLING" SHPK me seli ne Prizren ka marre vendim te shuaj biznesin me numer te regjistrimit 71098796 dhe me numer fiskal 601164829 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "Kosova Recycling" SHPK L.L.C u Prizren, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra : 71098796 sa fiskalnim brojem 601164829 I ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se sci klienti imaju obaveze I potrazivanja u navedenjo firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "KOSOVA RECYCLING" L.L.C in Prizren has come to the decision to quit its business with registry 71098796 and with the fiscal number 601164829. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

